



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



RRJETI I KOSOVËS PËR ARSIM DHE PUNËSIM

# ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK PËR ARSIMIN NË KOSOVË NË VITIN 2017

RAPORT VLERËSIMI



# ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK PËR ARSIMIN NË KOSOVË NË VITIN 2017

RAPORT VLERËSIMI

Dhjetor 2017

Raport vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë në vitin 2017

Hartimit të këtij raporti i kontribuan:

Dukagjin Pupovci, Kushtrim Bajrami, Ema Rraci, Besa Shahini, Vjollca Pllana, Erjona Pllashniku, Melinda Mula, Arlinda Gashi-Bajgora, Drilon Krasniqi, Muhamet Arifi, Diana Cena, Hana Zylfiu-Haziri, Luljeta Belegu-Demjaha, Agron Hajdari, Bariu Zenelaj.

## Falënderim

Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN) falënderon të gjithë ata që, me ofrim të informacionit, sugjerimeve dhe komenteve, kanë ndihmuar në hartimin e këtij raporti, në veçanti: anëtarët e Grupit të Punës për monitorimin e Planit Strategjik, ekspertët e angazhuar për asistencë teknike, zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), të DKA-ve, të partnerëve zhvillimorë dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe punëtorët e arsimit që i kanë ndarë përvojat dhe shqetësimet e tyre me ne.



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Agjencinë për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Akademinë e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave.....</b>	<b>8</b>
<b>Përmbledhje ekzekutive.....</b>	<b>11</b>
<b>1. Hyrje.....</b>	<b>16</b>
<b>2. Konteksti .....</b>	<b>18</b>
<b>3. Arsimi në politikat qeveritare .....</b>	<b>20</b>
3.1. Ndërlidhja në mes të politikave qeveritare.....	20
3.2. Buxheti për arsim.....	22
<b>4. Arritja e objektivave.....</b>	<b>24</b>
4.1. Objektivi 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja .....	26
4.1.1. Pjesëmarrja në edukimin parashkollor dhe parafillor.....	27
4.1.2. Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe të mesëm .....	29
4.1.3. Fëmijët me nevoja të veçanta.....	31
4.1.4. Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian .....	32
4.1.5. Përfshirja e fëmijëve të ri-atdhesuar .....	34
4.1.6. Përkrahja e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm .....	34
4.2. Objektivi 2: Menaxhimi i sistemit arsimor.....	36
4.2.1. Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim .....	37
4.2.2. Stafi drejtues i shkollës.....	37
4.2.3. Mekanizmat e financimit.....	38
4.2.4. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave.....	38
4.2.5. Legjislacioni .....	38
4.2.6. Mjediset shkollore - siguria dhe infrastruktura .....	39
4.3. Objektivi 3: Sigurimi i cilësisë.....	42
4.3.1. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë.....	43
4.3.2. Planifikimi zhvillimor i shkollës .....	45
4.3.3. Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë .....	46
4.3.4. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve .....	47
4.4. Objektivi 4: Zhvillimi i mësimdhënësve.....	50
4.4.1. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve .....	51
4.4.2. Licencimi i mësimdhënësve.....	52
4.4.3. Përgatitja e mësimdhënësve të rinj.....	53
4.5. Objektivi 5: Mësimdhënia dhe të nxënit.....	56
4.5.1. Zbatimi i kurrikulës së re.....	57
4.5.2. Tekstet Mësimore.....	58
4.5.3. Teknologjia arsimore .....	59
4.6. Objektivi 6: AAP dhe ARr.....	62
4.6.1. Trendet e regjistrimit dhe programeve mësimore .....	63
4.6.2. Kurrikulat dhe materialet mësimore.....	66
4.6.3. Puna praktike .....	67
4.6.4. Këshillimi dhe orientimi në karrierë.....	68
4.6.5. Arsimi i të rriturve .....	69
4.7. Objektivi 7: Arsimi i lartë .....	72
4.7.1. Struktura institucionale e arsimit të lartë.....	73
4.7.2. Studentët në arsimin e lartë.....	74
4.7.3. Personeli akademik.....	79
4.7.4. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë.....	81
4.7.5. Lidhja me tregun e punës .....	83
<b>5. Përfundimet .....</b>	<b>87</b>

## Lista e shkurtesave

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AAAPARr	Agjencia për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
APPK	Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
ARr	Arsimi për të Rriturit
ATTA	Akademia e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike
BE	Bashkimi Evropian
BEP	Programi i Arsimit Themelor i USAID
BPV	Bruto-Produkti Vendor
BSFK	Balkan Sunflowers Kosova
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPRMB	Ekipi për Reagim ndaj Mos-Regjistrimit dhe Parandalim të Braktisjes
ESIP	Projekti për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit
FE	Fakulteti i Edukimit
GiZ CDBE	Programi i GiZ për Ndërtim të Kapaciteteve në Arsimin Themelor
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim”
KKK	Korniza e Kurrikulës e Kosovës (po ashtu: Korniza e Kualifikimit e Kosovës)
KSHLM	Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve

MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJQ	Organizatë joqeveritare
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PRE	Programi për Reforma në Ekonomi
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
PZhSh	Plani Zhvillimor i Shkollës
QNP	Qendër për Ngritje Profesionale
SBASHK	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
SHFMU	Shkollë Filllore dhe e Mesme e Ulët
SKZh	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SMIAL	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
ToR	Termet e referencës
UA	Udhëzim Administrativ
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZHPM	Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve

## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport sjell një përmbledhje të rezultateve të monitorimit të zbatimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë, nga ana e organizatave të shoqërisë civile. Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021 (PSAK) është dokumenti bazë për zhvillimin e arsimit në periudhën 2017-2021, i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, monitorimi i zbatimit të PSAK realizohet në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN)”, koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), Ballkan Sunflowers Kosova (BSFK) dhe Akademia e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA).

Për realizimin e monitorimit është formuar një grup i veçantë i punës i përbërë nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës, të cilët, në bazë të kornizës së hartuar të monitorimit, kanë ofruar informata për progresin e PSAK. Gjatë procesit të monitorimit, përveç analizës së të dhënave që janë në dispozicion, janë mbledhur të dhëna shtesë nga MASHT, institucione të tjera publike dhe burime të tjera. Po ashtu, janë zhvilluar intervista në terren me punonjës dhe zyrtarë të arsimit, të cilat kanë ndihmuar shumë për të kuptuar perspektivat e të gjitha palëve me interes. Ka pasur vështirësi në sigurimin e disa të dhënave, të cilat nuk mblidhen nga institucionet përgjegjëse në Kosovë ose nuk janë ofruar nga institucioni prej të cilit janë kërkuar, përkundër kërkesës së parashtruar me kohë dhe në mënyrë të duhur.

## PËRFUNDIMET KRYESORE TË MONITORIMIT JANË:

Monitorimi është realizuar gjatë vitit 2017 dhe është përqendruar në objektivat strategjike të shtatë fushave të PSAK: 1) Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja; 2) Menaxhimi i sistemit arsimor; 3) Sigurimi i cilësisë; 4) Zhvillimi mësimdhënësve; 5) Mësimdhënia dhe të nxënësve; 6) Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimi për të Rritur (ARr); 7) Arsimi i lartë. Gjatë procesit të monitorimit është analizuar shkalla e arritjes së objektivave gjatë vitit të parë të zbatimit të PSAK, në raport me arritjen e regjuesve të përcaktuar, por edhe në raport me realizimin e masave që parashihen në PSAK.

Të gjeturat e kësaj analize tregojnë se arsimit i kushtohet kujdes në politikat qeveritare, por ka ngecje në zbatimin e politikave të përcaktuara, përfshirë Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021. Këto ngecje nuk kanë të bëjnë vetëm me mungesën e buxhetit, por edhe me çështje të natyrës organizative, ku kërkohet një angazhim i veçantë për jetësimin e masave strategjike nga ana e MASHT-it, si dhe një shkallë e lartë koordinimi me institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal. Është shumë ilustrativ fakti se Qeveria e Kosovës ka aprovuar PSAK-un me buxhet prej €176.9 mil. për pesë vjet, duke konstatuar ekzistimin e boshllëkut prej €89.6 mil., por nuk ka pasur veprime konkrete që të sigurohen këto mjete, edhe pse shumica e nevojshme për vitin 2017 ishte vetëm €9 mil. Po ashtu, nuk është ngritur ndonjë mekanizëm koordinues për zbatimin e PSAK.

✓ Kosova ka arritur një shkallë të lakmueshme të pjesëmarrjes në arsimin e obligueshëm, si dhe në arsimin e mesëm të lartë, ndërkaq pjesëmarrja në edukimin parashkollor mbetet sfidë për gjithë shoqërinë, kryesisht për shkak të mungesës së institucioneve me kosto të përballueshme. Braktisja e shkollimit është e një shkallë mjaft të vogël, përveç tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ku kërkohet vëmendje e veçantë. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me talente të veçanta mbeten kategoritë më të marginalizuara në arsimin parauniversitar.

✓ Nuk ka pasur progres në rregullimin e statusit të personelit drejtues të shkollave, të cilët vazhdojnë të jenë në varësi të drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave. Po ashtu, nuk ka një sistem të punësimit të punonjësve të arsimit që do të garantonte respektim të kriterëve dhe paanësi me rastin e marrjes së vendimeve për punësim. Ka pasur ngecje në aprovimin e legjislacionit të nevojshëm për zbatimin e reformës në arsim.

✓ Janë bërë hapat e parë për ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. Janë emëruar 140 nga 1,100 koordinatore të cilësisë në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, por ka indikacione se procesin e emërimit të koordinatorëve e karakterizon formalizmi. Janë krijuar parakushtet ligjore për vlerësimin e performancës së shkollës. Po ashtu, është zhvilluar metodologjia për vetëvlerësimin e shkollës, e cila është pilotuar në 63 shkolla.

✓ Nuk është ndërmarrë asnjë hap drejt themelimit të Agjencisë për Kurrikulum, Vlerësim dhe Standarde, përkundër faktit se kjo agjenci parashihet me ligjin e vitit 2011.

✓ Administrimi i testeve kombëtare mbetet pikë e dobët e zbatimit efektiv të tyre. Edhe këtë vit, MASHT nuk ka ndërmarrë hapa radikalë për përmirësimin e administrimit.

✓ Procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve akoma nuk ka filluar. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë plan i qartë veprimi për zhvillimin e këtij procesi në të ardhmen. Hartimi i UA për harmonizimin e gradave me sistemin e pagave nuk është realizuar, për shkak të mungesës së buxhetit. Rritja e pagave vazhdon të bëhet në mënyrë lineare dhe jo në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

✓ Zbatimi i kurrikulës së re filloi përkundër mungesës së teksteve mësimore dhe mjeteve të konkretizimit që janë në përputhje me kërkesat e kurrikulës së re. Nga shkollat raportohen vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e kurrikulës së re që janë pasojë e përgatitjeve të pamjaftueshme dhe mungesës së mbështetjes së vazhdueshme profesionale. Nuk është përcaktuar procesi i hartimit të teksteve të reja shkollore, nuk është shpallë konkursi për tekste të reja shkollore dhe as nuk janë pranuar dhe shqyrtuar propozimet nga shtëpitë botuese. Për më tepër, vazhdon të ketë dilema nëse tekstet shkollore do të hartohen nga botues vendorë, do të përkthehen nga gjuhë të huaja apo do të merren nga Shqipëria.

✓ Rreth 47% të nxënësve të arsimit të mesëm profesional vijojnë mësimet në drejtimet ekonomike-juridike dhe ato shëndetësore, me mundësi dukshëm më të vogla punësimi, ndërkohë që numri i nxënësve në drejtime me perspektivë më të mirë punësimi vazhdon të jetë nën nivelin e dëshiruar. Informatat nga terreni flasin për probleme serioze në realizimin e praktikës profesionale. Me pak përjashtime, këshillimi dhe orientimi në karrierë vazhdon të mos jetë i pranishëm në shkollat profesionale të Kosovës.

✓ Përkundër progresit në ofrimin e programeve për të rritur, arsimit të rriturve mbetet sektori më i pazhvilluar i sistemit të arsimit, pasi ende nuk janë krijuar parakushtet e domosdoshme për menaxhimin e tij.

✓ Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e lartë është 84.23% që e radhitë Kosovën në vendin e tetë në botë, ndërsa i tejkalon të gjitha vendet evropiane përveç Greqisë, Spanjës, Bjellorusisë dhe Finlandës.

✓ Numri i stafit akademik të kualifikuar në institucionet e arsimit të lartë është i pamjaftueshëm – derisa përpjesëtimi “mësimdhënës-student” në nivel vendi është 1:41, në sektorin publik mbetet akoma më i pavolitshëm – 1:60. Megjithatë ka përmirësime në zbatimin e kriterëve për zgjedhjen e stafit akademik, nuk ka pasur veprime konkrete për adresimin e shkeljeve flagrante të integritetit akademik nga ana e ndonjë institucioni të arsimit të lartë në Kosovë.

## NGA TË GJETURAT E ANALIZËS JANË NXJERRË KËTO REKOMANDIME:

- 1** MASHT-i duhet të ngritë një mekanizëm për koordinimin e zbatimit të PSAK 2017-2021 të udhëhequr nga Ministri ose zëvendësministri, ku do të marrin pjesë zyrtarët e lartë të MASHT, përfaqësues të pushtetit lokal dhe institucioneve të tjera që kanë obligime rreth zbatimit të PSAK-ut, përfaqësues të partnerëve zhvillimorë dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertë të arsimit. Detyrë e këtij mekanizmi do të ishte hartimi i planeve vjetore për zbatimin e PSAK-ut, rishikimi i progresit dhe këshillimi rreth hapave që duhet ndërmarrë për të siguruar zbatimin e plotë të planit strategjik.
- 2** Kujdes i veçantë në fushën e pjesëmarrjes në arsim duhet t'i kushtohet nivelit parashkollor, ku duhet të vazhdohet me investime në infrastrukturë dhe rritjen e përfshirjes në nivelin parafillor. Duhet të mbështeten qendrat mësimore për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, që të mundësohet pjesëmarrja dhe suksesi i tyre në shkollim, si dhe duhet vazhduar me dhënie e bursave për nxënës të shkollave të mesme nga këto komunitete.
- 3** MASHT duhet të aprovojë kritere dhe procedura unike dhe të qarta për punësimin e drejtorëve dhe mësimit në arsimin parauniversitar, në mënyrë që të minimizohet mundësia e punësimeve jomeritore dhe politike në sistemin e arsimit.
- 4** Kuvendi i Kosovës duhet të aprovojë Ligjin për Inspektoratin e Arsimit që hap rrugën për funksionalizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Po ashtu, duhet të mbështeten shkollat që ta përm-bushin funksionin e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- 5** Administrimi i testit të arritshmërisë dhe provimit shtetëror të maturës duhet të bëhet në atë mënyrë që të sigurohet besueshmëria e rezultateve, qoftë edhe duke marrë masa radikale ndaj shkelësve të rregullave të testit, përfshirë edhe administratorët.
- 6** Përkundër rezultatit jo të kënaqshëm të testit PISA, përpjekjet e MASHT dhe të gjithë faktorëve tjerë relevantë duhet të orientohen në përmirësimin thelbësor të gjendjes në sistemin e arsimit, e jo në përmirësimin mekanik të rezultateve të testit. Për më tepër, MASHT duhet të sigurojë një administrim kredibil të testit PISA, në mënyrë që rezultati të reflektojë gjendjen reale në sistemin e arsimit.
- 7** Rritja lineare e pagave të punonjësve të arsimit duhet të ndërpritet sepse nuk ka asnjë efekt të vetëm pozitiv. Për të motivuar mësimitdhënësit për punë më të mirë, duhet të funksionalizohet urgjentisht sistemi për licencimin e mësimitdhënësve, ndërsa pagat të lidhen me nivelin e licencës.
- 8** MASHT duhet të bëjë aranzhime të veçanta për monitorimin e zbatimit të kurrikulës së re dhe ofrimin e ndihmës shkollave në zbatimin e saj. Po ashtu, duhet të zgjidhet problemi i teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore në mbështetje të zbatimit të kurrikulës. Është i domosdoshëm hartimi i një plani për pajisjen e shkollave me teknologji dhe shfrytëzimin efektiv të saj.
- 9** Në bashkëpunim me DKA-të duhet bërë një rishikim të rrjetit të shkollave të arsimit profesional që të mos krijohet papunësi strukturore me regjistrimin e numrit të madh të nxënësve në drejtime ku mundësia e punësimit është e vogël, ndërkohë që ka mungesë të nxënësve në disa drejtime të tjera që kërkohen nga tregu i punës. Po ashtu, është e nevojshme që të përmirësohet puna praktike dhe këshillimi në karrierë, në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës.
- 10** Për shkak të numrit enorm të studentëve dhe numrit të vogël të personelit akademik të kualifikuar gjendja në arsimin e lartë nuk është e qëndrueshme. Për këtë arsye, kërkohet që AKA të vendosë kritere të qarta të cilësisë, në aspektin infrastrukturor, të përmbajtjes së programeve mësimore, si dhe në aspektin e numrit dhe cilësisë së stafit akademik, duke insistuar në përm-bushjen e tyre nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, pavarësisht nëse janë publike ose private. Për këtë qëllim, AKA duhet të ketë kapacitete për monitorimin e vazhdueshëm të institucioneve të arsimit të lartë, ashtu siç parasheh legjislacioni, si dhe duhet të sigurohet pavarësia e AKA nga ndikimet politike.



# 1. Hyrje

Më 7 dhjetor 2016, Qeveria e Kosovës aprovoi Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 (PSAK)<sup>1</sup>, dokument në të cilin ishte punuar për më tepër se një vit e që përcakton rrugën e zhvillimit të arsimit në periudhën vijuese pesëvjeçare. Misioni i PSAK është “zhvillimi i sistemit arsimor të bazuar në cilësi, në qasje gjithëpërfshirëse dhe në llogaridhënie, që mundëson formimin e individëve në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare”.

PSAK ka shtatë objektiva strategjike në këto fusha:

- 1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja;
- 2 Menaxhimi i sistemit arsimor;
- 3 Sigurimi i cilësisë;
- 4 Zhvillimi mësimdhënësve;
- 5 Mësimdhënia dhe të nxënit;
- 6 Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimi për të Rritur (ARr);
- 7 Arsimi i lartë.

Për secilin objektiv strategjik janë identifikuar rezultatet e pritshme, masat e mundshme, si dhe treguesit e suksesit që shërbejnë për monitorimin e zbatimit të PSAK-ut. Këto janë përmbledhur në një plan veprimi për zbatimin e PSAK-ut<sup>2</sup>. Po ashtu, është kalkuluar buxheti i PSAK-ut, i cili kap shumën e përgjithshme prej €176.94 mil.

Iniciativa për monitorimin e zbatimit të PSAK realizohet në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN)”, koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), Ballkan Sunflowers Kosova (BSFK), Akademia e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA) dhe SPARK.

Një ndër objektivat e projektit KEEN është pjesëmarrja në zhvillimin e politikave në fushën e arsimit dhe punësimit. Në kuadër të veprimtarisë së vet projekti ka mbështetur procesin e hartimit të PSAK, dhe, po ashtu, është përcaktuar ta bëjë monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti nga pozicioni i shoqërisë civile. Për këtë qëllim është hartuar një kornizë monitorimi, e cila përcakton metodologjinë e monitorimit. Për monitorimin e zbatimit të PSAK, aktivitetet përkatëse janë zberthyer dhe janë shndërruar në pyetje për të gjitha aspektet, segmentet dhe etapat konkrete të atyre aktiviteteve, si dhe janë identifikuar burimet e ndryshme konkrete për lehtësimin e monitorimit dhe për verifikimin e zbatimit të

1 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI\\_STRATEGJIK\\_I\\_ARSIMIT\\_NE\\_KOSOVE.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf)  
2 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-plani-i-veprimit.pdf>

atyre aktiviteteve. Këto aspekte dhe burime të monitorimit janë paraqitur në shtrirje kohore pesëvjeçare për periudhën 2017-2021. Po ashtu, është formuar një grup i punës për monitorimin e PSAK i përbërë nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës, të cilët, në bazë të kornizës së hartuar të monitorimit, kanë ofruar informata për progresin e PSAK.


Gjatë procesit të monitorimit, përveç analizës së të dhënave që janë në dispozicion, janë mbledhur të dhëna shtesë nga MASHT, institucione të tjera publike dhe burime të tjera. Po ashtu, janë zhvilluar intervista në terren me punonjës dhe zyrtarë të arsimit, të cilat kanë ndihmuar shumë për të kuptuar perspektivat e të gjitha palëve me interes. Ka pasur vështirësi në sigurimin e disa të dhënave, të cilat nuk mblidhen nga institucionet përgjegjëse në Kosovë ose nuk janë ofruar nga institucioni prej të cilit janë kërkuar, përkundër kërkesës së parashtruar me kohë dhe në mënyrë të duhur.

## 2. Konteksti

Në dhjetëvjeçarin e fundit Kosova ka pasur rritje ekonomike. Vlerësohet se bruto-produkti vendor i vitit 2016 u rrit për 3.5% dhe pritet që një rritje e ngjashme të ndodhë edhe në vitin 2017<sup>3</sup>. Sidoqoftë, Kosova vazhdon të ketë një ndër BPV-të më të ulëta për kokë banori në Evropë, ndërsa ekonomia e vendit vazhdon të jetë jostabile dhe e varur nga remitancat të cilat përbëjnë rreth 11% të BPV.

Sipas raportit të fundit për varfërinë, të realizuar në vitin 2015, 21.1% e popullsisë në Kosovë jeton në kushte të varfërisë, ndërsa 5.2% në varfëri ekstreme<sup>4</sup>. Raporti thekson faktin se faktor i rëndësishëm që kontribuon në zvogëlimin e varfërisë është niveli i arsimimit. Më shumë se një e treta e personave që nuk kanë përfunduar arsimin e obligueshëm jetojnë në ekonomi familjare të varfra, krahasuar me 12% të personave me kualifikime nga arsimit i lartë. Gati dy të tretat e personave të varfër kanë më pak se kualifikim të mesëm shkollor.

Rezultati i testit PISA i publikuar në fund të vitit 2016 konfirmoi edhe një herë se gjendja e arsimit në Kosovë nuk është aspak e kënaqshme. Përveç rankimit jo të mirë të Kosovës në raport me vendet tjera, brengë të madhe shkaktoi përqindja enorme e nxënësve që nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive për t'i shfrytëzuar njohuritë në jetë – në Lexim: 77% (mesatarja e OECD: 20%, Shqipëria: 51%, Maqedonia: 71%, Mali i Zi: 42%); në Matematikë: 78% (OECD: 23%, Shqipëria: 53%, Maqedonia: 70%, Mali i Zi: 52%); në Shkenca të natyrës: 68% (OECD: 21%, Shqipëria: 42%, Maqedonia: 63%, Mali i Zi: 51%). Deri në shpalljen e rezultatit të testit PISA, nuk ka ekzistuar asnjë argument i vetëm se sistemi i arsimit në Kosovë ndodhet në një gjendje aq të rëndë, përveç perceptimit të përgjithshëm shoqëror për cilësinë e ulët të arsimit, i cili doli të jetë i vërtetë.



<sup>3</sup> Staff Report; and Statement by the Executive Director for the Republic of Kosovo, IMF, 17 March 2017.  
<sup>4</sup> Consumption Poverty in the Republic of Kosovo 2012-2015, KAS, April 2017.

### Megjithatë, efektet e cilësisë së ulët të arsimit kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të dukshme. Disa nga shkaqet që kanë sjellë te kjo gjendje janë:

- ✓ Situata jonormale e viteve të nëntëdhjeta e cila i ka shkaktuar plagë të thella arsimit në Kosovë, në të gjitha nivelet.
- ✓ Shpërbërja efektive e të gjitha sistemeve për sigurimin e cilësisë në periudhën e pasluftës, duke filluar nga heqja e pedagogëve në shkolla, mbyllja e enteve pedagogjike, degradimi i rolit të Inspektoratit të Arsimit.
- ✓ Ndërtimi i një sistemi të administrimit që nuk nxitë përgjegjësinë, ku drejtorët e shkollave emërohen nga kryetarët e komunave, mësime të punësohen shpesh mbi baza të përshtatshmërisë politike, ndërkohë që nuk ekziston një sistem i mirëfilltë i llogaridhënies.
- ✓ Mangësitë në vlerësimin e jashtëm të nxënësve, në veçanti tolerimi i kopjimit masiv, që shkakton demobilizim tek nxënësit dhe shkollat, madje edhe tek prindërit.
- ✓ Degradimi i skajshëm i arsimit të lartë në Kosovë përmes politizimit, tolerimit të formave të ndryshme të shkeljes së integritetit akademik dhe masivizimit të pakontrolluar të këtij sektori.
- ✓ Mos-zbatimi i politikave arsimore të adoptuara dhe legjisacionit. Dokumentet strategjike të zhvillimit të arsimit në Kosovë nga viti 2004 janë hartuar me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve dhe, kryesisht, reflektojnë një konsensus të gjerë. Mirëpo, zbatimi i tyre në jetë nuk ndodhë, qoftë për shkaqe organizative ose financiare.

Në vitin 2017 Kosova ka pasur zgjedhje qendrore dhe lokale, të cilat, në masë të madhe e kanë zhvendosur vëmendjen e opinionit nga problemet e arsimit, por edhe kanë rezultuar me ngecje në zbatimin e politikave arsimore të proklamuar.

## 3. Arsimi në politikat qeveritare

Arsimi ka rol të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, duke iu mundësuar kështu individëve të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të luajnë rol produktiv në zhvillimin e shoqërisë. Si i tillë, përveç në PSAK 2017-2021, arsimi zë vend prioritar në dokumente të ndryshme strategjike të Qeverisë së Kosovës, përfshirë, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZh), Agjendën për Reforma Evropiane (ARE), Programin për Reforma në Ekonomi (PRE), dhe Programin Qeverisës të Republikës së Kosovës.

### 3.1. Ndërlidhja në mes të politikave qeveritare

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021** është dokument bazë strategjik që adreson politikat zhvillimore të rëndësishme të veçantë, duke përcaktuar kështu masat dhe aktivitetet konkrete për një periudhë afatmesme. Fusha e arsimit, si një ndër fushat prioritare është trajtuar në kapitullin e parë të Strategjisë - Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor. Në kuadër të kësaj shtylle janë paraparë masat që kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar, ndërlidhjen e arsimit me nevojat e tregut të punës, forcimin e llogaridhënies përmes inspektimit, vlerësimin e performancës dhe testeve të jashtme, si dhe me optimizimin e shpenzimeve në arsim përmes sistemeve të të dhënave.

**Agjenda për Reforma Evropiane** është dokument strategjik në të cilin janë përcaktuar masat dhe aktivitetet konkrete afatshkurtra për tri fusha prioritare: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; konkurrueshmërinë dhe klimën e investimeve; si dhe arsimin dhe punësimin. Në kuadër të fushës së arsimit për periudhën 2016 – 2017, ARE parasheh tri masa, si në vijim:

- Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit.
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit, nëpërmjet:
  - a. Rritjes së vijueshmërisë së edukimit parashkollor;
  - b. Realizimi i vlerësimit të jashtëm dhe përsheptimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë tekstet e reja shkollore në arsimin para-universitar;
  - c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve;
  - d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë;
  - e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët;
- Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në Punë.

**Programi për Reforma Ekonomike (PRE)** përcakton prioritetet e Qeverisë për përmbushjen e obligimeve kryesore të Kosovës nga MSA në fushën e ekonomisë. Në këtë drejtim, objektivi kryesor i Kosovës për fushën e arsimit është ndërlidhja e arsimit dhe aftësisit me kërkesat e tregut të punës, i cili është në harmonizim me SKZH, ARE dhe PSAK. Sa i përket këtij objektivi, PRE parasheh dy masa për periudhën 2016 – 2017, si në vijim:

- Masa reformuese #17: Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave.
- Masa e reformës #18: Zbatimi dhe përmirësimi i sistemit të karrierës për mësimdhënës.

**Programi Qeverisës i Republikës së Kosovës 2017-2021** synon të ndërtojë një model të ri arsimor i cili do të përqendrohet në reforma konkrete nga mësimi parashkollor deri tek avancimet akademike. Në kuadër të këtij programi, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) parasheh pesë objektiva për periudhën katërvjeçare 2017–2021 si në vijim:

1. Reformat në sistemin arsimor;
2. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore;
3. Përshtatja e sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës;
4. Bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim;
5. Hulumtimi zhvillimi dhe inovacioni.

### 3.2. Buxheti për arsim

Tabela në vijim jep të dhëna për shpenzimet në arsim në raport me bruto-produktin vendor dhe shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë. Të dhënat për shpenzime janë nxjerrë nga raportet vjetore të shpenzimeve të Ministrisë së Financave të Kosovës<sup>5</sup>, ndërkaq të dhënat për bruto-produktin vendor nga kornizat afatmesme të shpenzimeve.

Nga tabela vërehet se shpenzimet për arsim janë vazhdimisht në rritje dhe, po ashtu, është në rritje shpenzimi si përqindje e BPV-së, ku Kosova mund të krahasohet edhe me vendet e rajonit. Sipas të dhënave të UNESCO, në Shqipëri ky shpenzim përbën 3.5% të BPV në vitin 2013, në Bullgari – 3.5% (2012), në Kroaci – 4.2% (2011), në Serbi – 4.4% (2012), ndërsa në Slloveni – 5.7% (2012)<sup>6</sup>.

#### Shpenzimet për arsim (në miliona EUR)

	2013	2014	2015	2016
BPV	5,327.0	5,581.0	5,807.0	6,074.0
Shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë	1,474.7	1,463.5	1,553.1	1,763.2
Shpenzimet për arsim	203.1	229.4	260.7	279.9
Si përqindja e BPV	3.8%	4.1%	4.5%	4.6%
Si përqindje e shpenzimeve të Qeverisë	13.8%	15.7%	16.8%	15.9%

5 <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,29>  
6 [http://data.un.org/Data.aspx?d=UNESCO&f=series%3aXGDP\\_FSGOV](http://data.un.org/Data.aspx?d=UNESCO&f=series%3aXGDP_FSGOV)

Sa i përket shpenzimeve për arsim si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë vërehet një rritje prej 3% në periudhën 2013-2015, por në vitin 2016 ky shpenzim bie në 15.9% të shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë, duke rezultuar kështu në një rënie prej rreth 1% krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, në këtë aspekt, vërehet se Kosova shpenzon përpjesëtimisht më shumë se vendet e tjera të rajonit – Shqipëria – 12.1% (2013), Bullgaria – 10.7% (2012), Kroacia – 8.6% (2011), Serbia – 9.6% (2012) dhe Sllovenia – 12.6% (2012).

Një gjë që duhet vërejtur tek shpenzimet për arsim, është pjesëmarrja e lartë e pagave në këto shpenzime. Kështu, në vitin 2013, 78.6% e shpenzimeve për arsim janë për paga dhe mëditje<sup>7</sup>, ndërsa në vitin 2014 – 81.1%<sup>8</sup>. Arsyeja për këtë është rritja e vazhdueshme e pagave nga viti 2008 e cila nuk është përcjellë me rritje proporcionale të buxhetit për shpenzimet tjera të sistemit të arsimit.

PSAK 2017-2021 është aprovuar nga Qeveria me buxhet prej €176.9 mil. për periudhën 5-vjeçare, ku është vlerësuar se ekziston një boshllëk prej €89.6 mil., mjete financiare të cilat duhet të sigurohen nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët. Për vitin 2017 nga Buxheti i Kosovës është dashur të sigurohen rreth €9 mil. mjete shtesë por kjo nuk është realizuar. Për më tepër, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2018-2020<sup>9</sup> nuk parashihet që të ketë mjete shtesë as në periudhën vijuese 3-vjeçare. Objektivat e sektorit të arsimit në KASH janë po ato nga PSAK 2017-2021, por nuk parashihet ndonjë buxhet i veçantë për arritjen e tyre, përveç faktit se mjetet financiare për 430 norma mësimore më pak nuk janë hequr nga granti specifik për arsimin parauniversitar, por janë rezervuar për pagesën e koordinatorëve të cilësisë në shkolla, që parashihet me objektivin 3 të PSAK.

#### Shpenzimet për arsim

Për paga dhe mëditje



7 Raporti vjetor financiar për vitin 2013, Ministria e Financave. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0079C14F-1EF0-47EE-ADB5-57E79B805EFB.pdf>

8 Raporti vjetor financiar për vitin 2014, Ministria e Financave. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/12E08348-ABF1-4DC0-A125-63CCCA765126.pdf>

9 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FO499CD8-DB8B-48A0-9B2B-F313CB114E67.pdf>

## 4. Arritja e Objektivave

PSAK ka shtatë objektiva strategjike:

- ✓ Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.
- ✓ Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.
- ✓ Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- ✓ Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.
- ✓ Avancimi i të nxëniet përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.
- ✓ Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.
- ✓ Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Në vijim është analizuar shkalla e arritjes së objektivave gjatë vitit 2017, në raport me arritjen e treguesve të përcaktuar, por edhe në raport me realizimin e masave që parashihen në PSAK.

# PJESËMARRJA DHE GJITHËPËRFSHIRJA



## 4.1. Objektivi 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Në vitin shkollor 2016/17, përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor ka arritur 17.64% të grupmoshës 0-5, që paraqet progres në raport me 15.70% në vitin 2014/15 (Caku 2021: 20%).

Përfshirja e fëmijëve 5-vjeçarë në edukimin parafillor është rritur nga 79.6% (2014/15) në 85.5% (2016/17) (Caku 2021: 100%).

Përfshirja e fëmijëve 4-5 vjeç në edukimin parashkollor është rritur nga 40.7% (2014/15) në 46.44% (2016/17) (Caku 2021: 55%).

Pjesëmarrja e djemve dhe vajzave në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar vazhdon të jetë e balancuar, përveç në arsimin a mesëm të lartë ku ka vend për përmirësim. Indeksi i paritetit gjinor për këtë nivel të shkollimit është 0.91, ndërsa, në përputhje me strukturën e popullsisë, do të duhej të ishte 0.94.

Shkalla e braktisjes në arsimin e obligueshëm në vitin shkollor 2016/17 është 0.07%, ndërsa tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është 26 herë më e lartë – 1.85%.

Nuk ka fakte për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit, ndërsa identifikimi dhe kategorizimi i tyre vazhdon të jetë problem i theksuar.

Integrimi i fëmijëve të ri-atdhesuar në sistemin e arsimit është proces të cilit i kushtohet rëndësi e veçantë.

Në vitin shkollor 2016/17, numri i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor është rritur për 61% në raport me vitin shkollor 2015/16, ndërsa në nivelet tjera është stabilizuar. Me aprovimin e UA për funksionalizimin e qendrave mësimore janë krijuar parakushte për financimin e tyre nga fondet publike.

Me gjithë faktin se braktisja nuk është në shkallën kritike, mekanizmat për parandalimin e saj dhe të mosregjistrimit në shkollë nuk janë efektive.

Përveç në disa raste të izoluara, mungon përkrahja për fëmijë me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike.

### 4.1.1. Pjesëmarrja në edukimin parashkollor dhe parafillor

Nga Tabela 1 shihet se, në vitin shkollor 2016/17, numri i fëmijëve në edukimin parashkollor është shtuar për 7% në raport me vitin shkollor 2015/16, me një rritje prej vetëm 1% në sektorin publik dhe 123% në sektorin privat. Megjithatë, kjo rritje më shumë i atribuohet rregullimit të sistemit të mbledhjes së të dhënave nga sektori privat sesa rritjes së kapaciteteve pranuese në këtë sektor. Tabela përmban edhe të dhëna nga shkollat serbe që nuk ndikojnë shumë në totalitet – 621 fëmijë në vitin shkollor 2015/16 dhe 487 fëmijë në vitin shkollor 2016/17. Ndërkaq, mungojnë të dhënat e sakta për institucionet parashkollore të palicencuara, si dhe për qendrat me bazë në komunitet që ofrojnë edukim parashkollor për fëmijët.

Tabela 1. Fëmijët në edukimin parashkollor sipas tipit të institucionit

Tipi i institucionit	2015/16		2016/17	
	Gj	F	Gj	F
Publik	26,191	12,318	26,453	12,491
Privat	1,354	618	3,020	1,402
Gjithsej	27,545	12,936	29,473	13,893

Burimi: Statistikat e MASHT për vitet shkollorë 2015/16 dhe 2016/17

Në vitin shkollor 2016/17, përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor ka arritur 17.6%<sup>10</sup> të grupmoshës 0-5, që paraqet progres në raport me 15.7% në vitin 2014/15<sup>11</sup>. Shkaku kryesor për një pjesëmarrje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore me kosto të përballueshme.

<sup>10</sup> Numri i fëmijëve të moshës 0- 5 vjeç në edukimin parashkollor në vitin shkollor 2016/17 (Tabela 1) si përqindje e popullsisë së moshës 0- 5 vjeç në vitin 2016 (Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061, ASK, dhjetor 2013, f. 41.).

<sup>11</sup> Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021.



**Tabela 2.** Fëmijët e moshës 4-5 vjeç në edukimin parashkollor

Moshë	2015/16		2016/17	
	Gj	F	Gj	F
Moshë 4	1,794	878	1,954	938
Moshë 5	22,469	10,817	23,394	11,355
Gjithsej 4&5	24,263	11,695	25,348	12,293

Burimi: Statistikat e MASHT për vitet shkollore 2015/16 dhe 2016/17

Tabela 2 jep bazën për krahasimin e pjesëmarrjes në edukimin parashkollor në Kosovë me pjesëmarrjen në vendet e Bashkimit Evropian. Fokusi është tek pjesëmarrja në edukimin parashkollor të fëmijëve të moshës prej 4 vjeç deri në fillim të shkollimit të obligueshëm, e cila në vendet e BE arrin në 93.9% (2012), ndërsa synohet që deri në vitin 2020 të jetë 95%<sup>12</sup>. Ndërkaq, llogaritjet tona tregojnë se pjesëmarrja e grupmoshave 4 dhe 5 vjeç në Kosovë, në vitin shkollor 2016/17, është 46.4%<sup>13</sup> që paraqet **rritje** në raport me vitin shkollor 2014/15 kur ishte 40.7%<sup>14</sup> dhe një hap më afër caktimit të PSAK prej 55%<sup>15</sup>. Nga Tabela 2, po ashtu, vërehet një **rritje domethënëse** e regjistrimit në edukimin parashkollor. Pjesëmarrja e fëmijëve në këtë nivel tanimë ka arritur shkallën prej 85.5%<sup>16</sup> në raport me 79.6% në vitin shkollor 2014/15<sup>17</sup>. PSAK parasheh që deri në vitin 2021, të gjithë fëmijët e moshës 5 vjeç të përfshihen në edukimin parashkollor. Nga 20 klasa parashkolle të parapara të hapen në 2017, janë hapur vetëm 12.

PSAK nuk është përqendruar vetëm në rritjen e pjesëmarrjes në edukimin parashkollor, por edhe në përmirësimin e cilësisë. Për klasat parashkolle, në shtator 2017 ka filluar zbatimi i Kurrikulës së Re<sup>18</sup>. Katër edukatore të Qendrës Sociale Edukative SOS Kopshti<sup>19</sup> në shtator kanë filluar të punojnë me kurrikulën e re, pasi që kanë ndjekur trajnimin pesë ditor


12 <http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=tps00179&plugin=1>  
 13 Numri i fëmijëve të moshës 4 dhe 5 vjeç në edukimin parashkollor në vitin shkollor 2016/17 (Tabela 2) si përqindje e popullsisë së moshës 4 dhe 5 vjeç në vitin 2016 (Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061, ASK, dhjetor 2013, f. 41.).  
 14 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021.  
 15 Po aty.  
 16 Numri i fëmijëve të moshës 5 vjeç në edukimin parashkollor në vitin shkollor 2016/17 (Tabela 2) si përqindje e popullsisë së moshës 5 vjeç në vitin 2016 (Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061, ASK, dhjetor 2013, f. 41.).  
 17 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021.  
 18 Kurrikula Bërthamë për klasën përgaditore: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>; Planprogrami për klasën përgaditore: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/plani-dhe-programi-mesimor-kl-pergaditore.pdf>  
 19 Intervistë me Remzije Krasniqi, drejtoreshë e Qendrës Sociale Edukative SOS Kopshti, Prishtinë, 31.10.2017. Ky Institucion Parashkollor me bazë në komunitet subvencionohet pjesërisht nga Komuna e Prishtinës. Gjatë vitit 2017, nga numri total i 130 fëmijëve të moshës 3-6, komuna ka mbështetur financiarisht këtë institucion në përkujdesjen e 31 fëmijëve të margjinalizuar: të braktisur nga prindërit, pa përkujdesje prindërore, të nënave vetëushqyese, rasteve sociale, veteranëve të luftës dhe me nevojë të veçanta.

për zbatimin e saj. Ato<sup>20</sup> theksojnë se ndër përparësitë e punës me kurrikulën e re janë integrimi ndër-fushor i temave që shtjellohen në klasë, planifikimi dy-mujor, i cili shkoqit temat dhe lehtëson planifikimet javore dhe ditore, si dhe bashkëpunimi më i ngushtë i edukatoreve, i cili u mundëson ndarjen e ideve dhe përvojave në mes vete. Por edukatorët<sup>21</sup> shprehen të pakënaqura me nivelin e njohurive që kanë fituar gjatë trajnimeve për kurrikulën e re. **Trajnerët nuk kanë qenë mjaft të përgatitur për të përcjellë njohuritë tek pjesëmarrësit**, dhe nuk kanë pasur materiale të mjaftueshme e as programe adekuate lëndore. Gjithashtu, trajnimi ka qenë shumë i ngjeshur, dhe ka përfshirë pjesëmarrës të niveleve të ndryshme, gjë që u ka kufizuar mundësinë që të përfitojnë njohuritë e mjaftueshme për nivelin parashkollor.

#### 4.1.2. Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe të mesëm

Kosova vazhdon të ketë pjesëmarrje solide në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në krahasim me vendet tjera evropiane, gjë që ka qenë e evidente edhe gjatë hartimit të PSAK-ut. Për këtë arsye, fokusi i Planit Strategjik ka qenë tek përmirësimi i përfaqësimit gjinor, shtimi i regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë dhe minimizimi i braktisjes së shkollimit.

**Tabela 3.** Treguesit e pjesëmarrjes në arsim



20 Intervistë me Laureta Hasanaj, Aida Ismailin dhe Afërdita Kavajen, edukatore në Qendrën Sociale Edukative SOS Kopshti, Prishtinë, 03.11.2017.  
 21 Intervistë me Laureta Hasanaj, Aida Ismailin dhe Afërdita Kavajen, edukatore në Qendrën Sociale Edukative SOS Kopshti, Prishtinë, 03.11.2017.

Tabela 3 jep një pasqyrë të treguesve relevantë për pjesëmarrje në arsimin parauniversitar. Indeksi i paritetit gjinor paraqet herësin e numrit të femrave dhe të meshkujve të grupmoshave të caktuara. Në fazën e hartimit të PSAK janë përcaktuar indeksat në bazë të të dhënave të vitit shkollor 2014/15, si dhe caqet për vitin 2021, duke u bazuar në projeksionin e popullsisë dhe faktin se popullsia e Kosovës ka më shumë meshkuj sesa femra. Indeksat e paritetit gjinor të kalkuluara për vitet shkollorë 2015/16 dhe 2016/17 flasin për **progres drejt cakut, përveç në rastin e nivelit parashkollor (0-5 vjeç) dhe të mesëm të lartë (15-17 vjeç)** ku duhet punuar për përmirësimin e paritetit gjinor. Po ashtu, regjistrimi në shkollën e mesme të lartë i 99.4% të atyre që kanë mbaruar klasën e nëntë mund të **konsiderohet si sukses**.

Tabela 4 jep një pasqyrë të braktisjes së shkollimit në tri vitet e fundit. Nga tabela mund të vërehet se vajzat nuk përbëjnë më shumë se 30% të nxënësve që braktisin shkollimin. Një analizë më e thellë e të dhënave nga SMIA tregon se **një numër i konsiderueshëm i braktisësve në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët janë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**. Kështu, në vitin shkollor 2014/15, pjesëtarët e këtyre komuniteteve përbëjnë 48.1% të nxënësve braktisës në klasat 1-9, në vitin shkollor 2015/16 – 43.3%, ndërsa në vitin shkollor 2016/17 – 57.5%. Nga po këto të dhëna vërehet se, në vitin shkollor 2014/15, shkalla e braktisjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ka qenë 3.88% (kundruall 0.19% në nivel vendi); në vitin shkollor 2015/16 – 3.98% (0.19% në nivel vendi); ndërsa në vitin shkollor 2016/17 – 1.85% (0.07% në nivel vendi).

**Tabela 4.** Braktisja e shkollimit

Niveli i shkollimit	2014/15		2015/16		2016/17	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F
FMU (Klasat 1-9)	528	254	488	214	174	69
I mesëm i lartë (Klasat 10-12)	1,445	325	1,805	469	1,382	350
Gjithsej	1,973	579	2,293	683	1,556	419

Burimi: Të dhënat nga SMIA për vitet shkollorë 2014/15, 2015/16 dhe 2016/17

Formimi i Ekipeve për Reagim ndaj Mos-Regjistrimit dhe Parandalim të Braktisjes - EPRMB është një hap i rëndësishëm për tu siguruar të gjithë fëmijëve të drejtën për edukim, dhe për ti përkrahur ata në procesin mësimor. Gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave për këtë raport kuptohet se në shumicën e komunave janë formuar EPRMB në nivel komunal dhe shkolle. **Mirëpo, shumica e EPRMB nuk janë funksionale dhe nuk ka monitorim të tyre**. Në komunën e Fushë Kosovës<sup>22</sup> e cila ka një numër të madh të pjesëtarëve të komunitetit ashkali, por edhe të komuniteteve rom dhe egjiptian, formimi i ekipit EPRMB ka qenë i domosdoshëm, ngase fëmijët e këtyre komuniteteve kanë një prevalencë më të lartë të braktisjes dhe mosvijueshmërisë së rregullt të mësimin. Ndonëse ky ekip në nivel komunal në bashkëpunim me ekipet e formuara në nivel shkolle funksionon mjaft mirë, braktisja e shkollës në këtë komunë vazhdon të jetë mjaft shqetësuese.

Sa i përket trajnimit të ekipeve të EPRMB në nivel komune dhe në nivel shkolle për zbatimin e dokumenteve ekzistuese, i cili parashihet në planin e veprimit të PSAK, MASHT<sup>23</sup> informon se ky trajnim është realizuar në 31 komuna të Kosovës, mirëpo jo në të gjitha shkollat. MASHT gjithashtu ka bërë rishikimin e treguesve, hartimin e instrumenteve për paralajmërim të hershëm të braktisjes dhe përcaktimin e procedurave standarde operative. Përkundër të gjitha përpjekjeve, efekti i ekipit për kthimin e nxënësve që braktisin shkollën nuk konsiderohet të jetë në nivelin e dëshirueshëm.

Në shkollën “Selman Riza” në Fushë Kosovë<sup>24</sup> është formuar EPRMB nga pesë anëtarë: drejtoresha, dy mësime të mësimdhënësve, një nxënës, dhe një mediator nga Qendra e Komuniteteve. Ekipi është mjaft aktiv për kthimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën duke ndërmarrë hapa të ndryshëm, si vizitat nëpër shtëpi, vizitave të rregullta të mediatorit në shkollë për të monitoruar vijueshmërinë e nxënësve të kthyer, si dhe përmes takimeve të shpeshta të ekipit.

Edhe në shkollën “Zenel Hajdini”<sup>25</sup> ekziston një EPRMB pesë anëtarësh i përbërë nga psikologja e shkollës, dy mësime të mësimdhënësve, një prind dhe një nxënës. Përmes bashkëpunimit të ngushtë të pjesëtarëve të ekipit me këshillin e nxënësve dhe këshillin disiplinor të shkollës, si dhe përmes monitorimit të rregullt të vijueshmërisë së mësimin dhe adresimit të menjëhershëm të rasteve të nxënësve më shumë mungesa, kjo shkollë ka arritur që të parandalojë braktisjen e shkollës së nxënësve të saj në një nivel shumë të kënaqshëm. Gjatë vitit 2017, në këtë shkollë EPRMB ka arritur të parandalojë braktisjen e rreth 18 nxënësve.

#### 4.1.3. Fëmijët me nevoja të veçanta

Të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit vazhdojnë të jenë të mangëta. Në publikimin zyrtar të statistikave të arsimit thuhet se “saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin se akoma nuk janë vlerësuar të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasat e rregullta nga ekipet vlerësuese profesionale në komuna”<sup>26</sup>. Në fakt, statistika flet për 5,294 nxënës me nevoja të veçanta të përfshirë në klasat e rregullta dhe 271 syresh të përfshirë në shkollat speciale në vitin shkollor 2016/17. Duke krahasuar të dhënat me ato të vitit shkollor 2015/16 (5,815 në klasa të rregullta dhe 357 në shkolla speciale)<sup>27</sup> vërehet një zvogëlim prej 9.8% i pjesëmarrjes së nxënësve me nevoja të veçanta, gjë që tregon se sistemi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për këtë kategori lë shumë për të dëshiruar. Hartimi i instrumenteve për vlerësim të nevojave pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta – e paraparë për 2017 - është realizuar. MASHT<sup>28</sup> thekson se nga nëntori 2017 deri qershor 2018 do të fillojë pilotimi i tyre në 7 shkolla të 7 komunave: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Pejë dhe Gjilan. Nga viti 2018/19 pritet të fillojë zbatimi i këtyre instrumenteve në të gjitha shkollat.

22 Intervistë me Islam Shabanin, drejtor i Arsimit në Fushë Kosovë, 16.10.2017

23 Intervistë me Avni Rexhën, Udhëheqës i Divizionit për arsim të përgjithshëm, MASHT, 02.10.2017

24 Intervistë me Nexhmije Hykollin, sekretare e shkollës “Selman Riza” në Fushë Kosovë, 18.10.2017.

25 Intervistë me Shkurta Krasniqin, zëvendës-drejtoreshë në SHFMU “Zenel Hajdini” Prishtinë, 19.10.2017.


26 Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016/17, MASHT-ASK, 2017.

27 Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/16, MASHT-ASK, 2016.

28 Interviste me Lulavere Behluli, Udhëheqëse e Divizionit për arsim me nevoja të veçanta, MASHT, 02.10.2017



## Fëmijët me nevoja të veçanta



Klasa të rregullta	5,815	5,294
Shkolla speciale	357	271

### 4.1.4. Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian

Pjesëmarrja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian tregon një trend të qartë të rritjes në nivelin parashkollor dhe është relativisht e stabilizuar në nivelin e arsimit të obligueshëm dhe atij të mesëm të lartë (Tabela 5). Megjithatë, nga këto të dhëna është e pamundur të vlerësohet progresi i pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit, pasi mungojnë të dhënat referente për popullsinë. Një vlerësim i tillë mund të bëhet vetëm përmes anketës specifike të realizuar në vitin 2014<sup>29</sup>.

**Tabela 5.** Fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar

## Fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar



Niveli parashkollor	373	601
Klasat 1-9	5,524	5,544
Klasat 10-12	431	413

Burimi: Statistikat e MASHT për vitet shkollorë 2015/16 dhe 2016/17

<sup>29</sup> Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2013-2014 – Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MICS), Raporti final, ASK, Prishtinë 2014

Megjithatë, ka një shpjegim për rritjen e pjesëmarrjes në edukimin parashkollor. Organizata të shumta të shoqërisë civile kanë punuar në ofrimin e ndihmës për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë nivel shkollimi, në mënyrë që përgatitjet e tyre për arsimin e obligueshëm të jenë sa më cilësore.

PSAK parasheh dy mënyra kryesore për adresimin e nevojave mësimore të nxënësve që vijnë nga komunitetet e përmendura:

1. përmes avancimit të punës së qendrave mësimore dhe
2. lehtësimit të kushteve të regjistrimit.

Qendrat mësimore janë institucione shkollorë joformale, të menaxhuara nga OJQ-të dhe të cilat financohen nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Ato ofrojnë shërbime plotësuese arsimore për fëmijët në nevojë, me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre në shkollë dhe integritet të tyre në shoqërinë e gjerë. Posaçërisht, këto shërbime u ofrohen grupeve të marginalizuara apo me vështirësi në nxënie që vjen nga mosnjohja e gjuhës, përkatësia komunitet jo-shumicë, etj.

Në gusht 2017 MASHT ka aprovuar udhëzimin administrativ që rregullon funksionalizimin e këtyre qendrave.<sup>30</sup> Ky Udhëzim përcakton kornizat formale brenda të cilave veprojnë qendrat mësimore, të cilat ofrojnë mësim shtesë dhe aktivitete edukative për nxënësit e moshës parafillore dhe fillore në Kosovë, në veçanti për nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian<sup>31</sup>. Gjithsej në 15 komuna<sup>32</sup> janë 40 qendra mësimore, të cilat punojnë me programe jo të harmonizuara mes veti.

Qendra Mësimore e organizatës “The Ideas Partnership” në Fushë Kosovë, ofron mësim plotësues për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke përcjellë planprogramin me të cilin punohet në SHFMU “Selman Riza” në Fushë Kosovë ku shumica e përfituesve të kësaj qendre vijnë në mësimin. Mësimi plotësues ofrohet nga vullnetarët, dhe planprogrami përgatitet nga pedagogia e qendrës mësimore, e cila po ashtu e monitoron zbatimin e planprogramit. Ky planprogram synon të pasqyrojë edhe rezultatet e pritura të të nxënësve. Përveç lëndëve bazike si gjuha shqipe, matematika dhe gjuha angleze, në këtë planprogram përfshihen edhe tema në fushën e shëndetit, jetës dhe punës, si dhe aktivitete rekreative. Pra, përveç ngritjes së kapaciteteve të nxënësve në aspektin akademik, kjo qendër mësimore synon të zhvillojë edhe shkathtësi të tjera tek përfituesit, si: kulturën e komunikimit, shprehitë e punës, socializimin, dhe vetëdijësimin rreth rëndësisë së shkollimit.<sup>33</sup> Sipas pedagoges “më tepër se harmonizimi i planprogrameve në mes të qendrave të ndryshme mësimore në vend, është i nevojshëm harmonizimi i planeve dhe bashkëpunimi më i ngushtë në mes të shkollës ku fëmijët vijnë në mësimin dhe qendrave mësimore ku ata vijnë në mësimin plotësues.”<sup>34</sup> Ky koordinim në mes të shkollës dhe qendrës mësimore do t’i mundësonte qendrës mësimore që të ofrojë edhe më tepër mbështetje akademike për fëmijët gjatë mësimin plotësues.

Plani i veprimit i PSAK parasheh hartimin e rregullores për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel parashkollor dhe shkollat e mesme të larta, gjë që nuk është realizuar deri në shtator 2017.<sup>35</sup>

<sup>30</sup> <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/ua-masht-nr-12-2017-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qmpdf.pdf>

<sup>31</sup> <http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/miratimi-i-udhezimit-administrativ-nr-12-2017-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-nga-ministria-e-arsimit/>

<sup>32</sup> [http://uboconsulting.com/PDF/al/Study\\_on\\_Impact\\_and\\_Sustainability\\_of\\_the\\_Learning\\_Centers-ALB.PD](http://uboconsulting.com/PDF/al/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-ALB.PD)

<sup>33</sup> Intervistë me Valentina Osmani, pedagoge dhe koordinatorë për mësimdhënie në Qendrën mësimore të Ideas Prtnership në Fushë Kosovë, 18.10.2017

<sup>34</sup> Intervistë me Hysni Hasanin, koordinator i projekteve të Qendrës Ideas Partnership, 18.10.2017.

<sup>35</sup> <http://masht-smia.net/30.pdf>

MASHT planifikon të hartojë një UA për lehtësimin e kushteve të regjistrimit,<sup>36</sup> por, sipas MASHT, mungesa e këtij Udhëzimi nuk do të duhej të pengonte lehtësimin e kushteve të regjistrimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. Komuna e Fushë Kosovës<sup>37</sup> dhe Shtimes janë shembuj të mirë, ku përkundër mungesës së rregullores organizohen aktivitete të ndryshme për të lehtësuar regjistrimin në shkollë<sup>38</sup> të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, siç janë: mbledhja me prindër në qendrat e komunitetit, angazhimi i aktivistëve të komuniteteve, apo vizitat shtëpiake nga anëtarët e EPMPB në nivel komune dhe në nivel shkolle.

#### 4.1.5. Përfshirja e fëmijëve të ri-atdhesuar

Gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/2017, rreth 300-320 nxënës të ri-atdhesuar janë pajisur me tekste shkollore dhe mjete didaktike të dedikuara për ta. Në mbështetje të arsimit të fëmijëve të ri-atdhesuar, është realizuar edhe trajnimi me zyrtarë komunal për programin e të ri-atdhesuarve. Gjithsej 11 zyrtarë komunalë kanë marrë pjesë në këto trajnime. Mësimdhënësit e përzgjedhur për zbatimin e planprogramit kanë ndjekur një punëtori njëditore në 11 komunat e përfshira. Gjithashtu MASHT<sup>39</sup> konfirmon se është realizuar monitorimi i mësimin plotësues nga ana e komunave, siç parashihet nga plani i veprimit për 2017. MASHT në bashkëpunim me GIZ kanë krijuar grupe punuese me zyrtarë komunal për monitorimin e mësimin plotësues nëpër shkolla. Sipas raportit të monitorimit, mësimi plotësues është realizuar.

#### 4.1.6. Përkrahja e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm

Instituti ATOMI është organizata e vetme në Kosovë që merret me identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve dhe të rinjve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual. Që nga viti 2011 projekti ATOMI ka identifikuar gjithsej 221 persona me potencial të jashtëzakonshëm intelektual nga e gjithë Kosova (të moshës 13-23 vjeçare, nga të dyja gjinitë dhe pothuajse nga të gjitha komunat dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë). Për nxënësit e përzgjedhur Atomi ofron falas disa shërbime dhe aktivitete (në përputhje me mundësitë që ka në dispozicion) si: shërbime të këshillimit psikologjik dhe shërbime të orientimit në karrierë, shkollë/kamp veror me kurse të avancuara, vizita studimore dhe aktivitete sociale e rekreative<sup>40</sup>.

Gjatë vitit 2017, "Atomi" është mbështetur nga MASHT me një shumë totale prej 15,000 EUR. Po ashtu, është përkrahur edhe nga burime private.<sup>41</sup> Megjithatë, MASHT nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet për të identifikuar fëmijët me talente të veçanta në kuadër të sistemit arsimor, ose për të ofruar ndonjë shërbim për këtë kategori. Aktiviteti i vetëm që mbështetet nga MASHT është organizimi i garave për nxënës të shkollave të mesme nga Shoqata e Matematikanëve të Kosovës, ku fituesit dërgohen në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës.

36 Interviste me Nazan Safiqin, Udhëheqëse e Divizionit për Arsim të Komuniteteve, MASHT, 02.10.2017.

37 Interviste me Islam Shabanin, drejtor i Arsimin në Fushë Kosovë, 16.10.2017.

38 Interviste me Nexhmije Hykollin, sekretare e shkollës "Selman Riza" në Fushë Kosovë, 18.10.2017.

39 Interviste me Avni Rexhën Udhëheqës i Divizionit për arsim të përgjithshëm, MASHT, 02.10.2017.

40 Interviste me Jusuf Thaçin, drejtor ekzekutiv i "Atomi", 01.12.2017.

41 Po aty.

# MENAXHIMI I SISTEMIT ARSIMOR



## 4.2. Objektivi 2: Menaxhimi i sistemit arsimor

**Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.**

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Aktivitetet e orientuara kah ndërtimi i kapaciteteve në nivelin qendror dhe komunal nuk janë zhvilluar sipas planifikimit dhe kanë pasur efekte të kufizuara.

Nuk ka pasur progres në rregullimin e statusit të stafit drejtues të shkollës, i cili vazhdon të varet nga vullneti i kryetarit të komunës.

Janë certifikuar 71 pjesëmarrës të trajnimeve për udhëheqje arsimore, ndërsa është në proces organizimi i katër grupeve të tjera për trajnim në këtë fushë.

Në KASH 2018-2020 janë përfshirë disa shpenzime që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të reja të MASHT në nivelin lokal, siç është buxheti për 560 koordinatorë të cilësisë në shkollat e Kosovës. Rishikimi i formulës së financimit për arsimin parauniversitar është në rrjedhë e sipër.

Janë bërë përgatitjet për integrimin e të dhënave statistikore në tërësi që bëjnë të mundur shfrytëzimin efektiv të tyre për politikëbërje.

Ka ngecje në aprovimin e legjisllacionit të nevojshëm për zbatimin e reformës në arsim, siç është Ligji për Inspektoratin e Arsimit, i finalizuar në vitin 2016.

Janë zhvilluar aktivitete për parandalimin e dhunës në shkolla, por nuk është realizuar planifikimi lidhur me ngritjen e nivelit të sigurisë në shkolla.

Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe parashkollore është realizuar sipas planifikimit, si dhe furnizimi i shkollave me inventar, ndërkaq nuk ka të dhëna të besueshme për renovimin e objekteve shkollore ekzistuese.

### 4.2.1. Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim

Edhe pse me planin e veprimit për vitin 2017 parashihet vlerësimi i nevojave të DKA-ve për zhvillim profesional, nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Megjithatë, GIZ CDBE planifikon që nga muaji tetor 2017 të mbështesë Kolegjiumin për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës në hartimin e një plani të veprimit në kuadër të të cilit si një prej aktiviteteve, do të përfshihet vlerësimi i nevojave për zhvillim profesional të DKA-ve. Plani i veprimit të PSAK për vitin 2017 ka parashikuar hartimin e tre manualeve (Manuali për monitorimin e procesit arsimor në komuna, Manuali për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, Manuali për trajnim të stafit mësimdhënës dhe atij administrativ në shkolla), mirëpo deri në periudhën e raportimit, GIZ CDBE ka bërë vetëm rishikimin e Doracakut për Qeverisjen e Arsimit në Komuna të publikuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në vitin 2015<sup>42</sup>.

Gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave është kuptuar se nuk ka pasur ndonjë analizë të nevojave për zhvillim profesional të personelit të MASHT gjatë vitit 2017, që do të përqendrohej në trajnimet për politikëbërje dhe monitorim, siç parashihej në PSAK. Ndërkaq, takimet e rregullta mujore në mes të MASHT dhe DKA janë të karakterit rutinor dhe aty, kryesisht, diskutohen detyrat aktuale të këtyre institucioneve. Këto nuk kanë formën e takimeve ku trajtohen tema më komplekse të arsimit, siç kërkohet në PSAK, dhe njëjtë ka qenë edhe gjatë vitit 2017.

Sipas të dhënave nga terreni, këshillat e prindërve ekzistojnë në të gjitha shkollat, por nuk funksionojnë në një numër të konsiderueshëm të shkollave. Ligji bën të mundur që në rast të mosfunksionimit të Këshillit të prindërve brenda një periudhe 6-mujore, autorizimet e këtij organi kalojnë tek drejtori i Shkollës (i emëruar nga kryetari i Komunës). Kjo bën që të defunksionalizohet një organ me rëndësi që përfaqëson interesat e shkollës dhe të komunitetit të shkollës. Monitorimi i punës së këshillave të prindërve është i paraparë me PSAK 2017, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë.

Nga të dhënat e mbledhura deri më tani kuptohet se GIZ CDBE planifikon të vazhdojë trajnimet me këshillat drejtues të shkollave në komunat partnere: Gjilan, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Prizren. Pasi që një numër i shkollave kanë qenë më herët të përfshira në këto trajnime që janë ofruar nga GIZ CDBE dhe BEP, nga viti 2017 janë përfshirë vetëm shkollat e komunave partnere të cilat nuk kanë qenë të përfshira më herët. Rrjetet e shkollave, të quajtura “komunitetet e të nxënit së bashku”, të krijuara më herët në komunat partnere të GIZ CDBE kanë qenë funksionale. Nga viti 2017 është zgjeruar rrjeti i shkollave “komunitetet e të nxënit së bashku”, me ç’rast janë përfshirë edhe komunat jo partnere siç janë: Shtimja dhe Gjakova dhe po ashtu planifikohet që të vazhdohet me zgjerimin e rrjeteve edhe në Mitrovicë. Gjatë vizitës në SHFMU “Ismail Qemali”<sup>43</sup> në Prishtinë kuptohet se kjo shkollë është përfshirë në aktivitetin “komunitetet e të nxënit së bashku” që nga fillimi i këtij viti shkollor, në bashkëpunim me shkollën “Xhemajl Mustafa” si bartëse e këtij aktiviteti dhe me pesë shkolla të tjera. Përshtypjet e deritanishme të këtij aktiviteti janë pozitive.

### 4.2.2. Stafi drejtues i shkollës

Në përputhje me legjisllacionin në fuqi, drejtorët vazhdojnë të emërohen nga kryetarët e komunave, me mandate 4-vjeçare, në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga MASHT<sup>44</sup>. Drejtorët janë të licencuar vetëm si mësimdhënës, dhe për të aplikuar për një pozitë të tillë ata/ato duhet patjetër të jenë të trajnuar në ndonjë program të akredituar për udhëheqje arsimore. Mungon përcaktimi që drejtori të jetë një profesionist, pozita e të cilit nuk varet nga vullneti i

42 <http://www.cdbe.info/wp-content/uploads/2015/07/03-Doracak-p%C3%ABr-Qeverisjen-e-Arsimit-n%C3%AB-Komuna.pdf>.

43 Intervistë me Hatmane Demiri, drejtoreshë e shkollës “Ismail Qemali” Prishtinë, 06.10.2017.

44 Udhëzimi Administrativ 08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativ-arsimor dhe aftësues, MASHT.

kryetarit të Komunës. Për këtë arsye nuk ka sistem të mirëfilltë të licencimit të menaxherëve të shkollave.

Edhe pse është parashikuar krijimi i rregullativit për monitorim të performancës së drejtorëve të shkollave gjatë vitit 2017, nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Drejtori është shërbyes civil dhe performanca e tij/saj mund të vlerësohet në bazë të rregullave të shërbimit civil, por, në praktikë as kjo nuk ndodhë<sup>45</sup>.

Sa i përket trajnimeve në udhëheqje arsimore kuptohet se ato kanë rifilluar në vitin 2017 dhe 4 grupe janë në proces si organizim i GIZ CDBE. Ndërsa, nga grupet që kanë filluar në vitin 2016, janë certifikuar në vitin 2017 gjithsej 71 pjesëmarrës prej të cilëve 34 meshkuj, dhe 37 femra. Vlen të theksohet se 24 prej tyre janë të nacionalitetit serb nga komuna e Gjilanit. GIZ CDBE ofron materialet trajnuese, siguron cilësinë dhe bën vlerësimin e pjesëmarrësve në përfundim të trajnimit, ndërsa, OJQ-të të cilat kanë marrëveshje me GIZ CDBE i implementojnë trajnimet.

#### 4.2.3. Mekanizmat e financimit

Edhe pse MASHT e ka theksuar si prioritet në PSAK rishikimin e formulës së financimit të arsimit parauniversitar dhe kjo është planifikuar në kuadër të projektit ESIP, një gjë e tillë nuk është realizuar deri në nëntor të vitit 2017. Kjo ka ndikuar edhe në mos realizimin e trajnimit të zyrarëve të DKA-ve për menaxhim financiar. Gjithashtu, nuk është bërë një analizë e pritit e efektshmërisë së planifikimit buxhetor në nivelin qendror dhe lokal. Megjithatë, në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020 janë përfshirë disa shpenzime që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të reja të MASHT në nivelin lokal, siç është buxheti për 560 koordinatorë të cilësisë në shkollat e Kosovës.

Gjatë fushatës për zgjedhje nacionale të vitit 2017, nga subjekte që, më vonë kanë formuar koalicionin e ri qeverisës, janë dhënë premtime për rritjen e pagave në shërbimin publik në lartësi prej 30%<sup>46</sup>, por është realizuar vetëm rritje në lartësinë prej 4%<sup>47</sup>, edhe atë duke filluar prej 1 janar 2018. Kjo ka tensionuar raportet në mes të Qeverisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), e cila ka kërcënuar me greva të punonjësve të arsimit<sup>48</sup>.

#### 4.2.4. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Përgatitja dhe publikimi i raporteve të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA janë të domosdoshme për shfrytëzimin e tyre në politikëbërje. Për këtë qëllim, projekti ESIP është duke punuar në draft-konceptin për ristrukturimin e divizionit të statistikave, dhe si rezultat, pritit që kapacitetet e SMIA të ngritën pas ristrukturimit të divizionit. Po ashtu në kuadër të projektit ESIP ka filluar procesi për avancimin e sistemit SMIA. Në këtë fazë, janë përgatitur vetëm ToR në të cilat parashihet që të integrohen sistemet e ndryshme (sistemi i licencimit, vlerësimi i nxënësve, të dhënat e infrastrukturës të shkollave, procesi i licencimit të shkollave, databazat e nxënësve dhe mësimdhënësve) në një sistem të vetëm.

#### 4.2.5 Legjislacioni

Harmonizimi dhe kompletimi i Legjislacionit për tërë sektorin e arsimit parauniversitar është një rezultat me rëndësi i paraparë në Planin e Veprimtimit të PSAK për vitin 2017, mirëpo deri më tani nuk ka pasur ndonjë analizë gjithëpërfshirëse

45 Email nga Vesel Hoda, GIZ CDBE, 3 nëntor 2017.

46 <http://www.gazetaexpress.com/zgjedhjet-2017/veseli-e-haradinaj-garantoje-per-rritje-30-te-pagave-per-mesimdhene-sit-383407/>

47 <http://indeksonline.net/punetoret-qe-marrin-page-nga-buxheti-i-shtetit-u-rriten-pagat/>

48 <http://www.epokaere.com/sbashk-u-nese-pagat-rriten-vetem-4-per-qind-nga-janari-ne-greve/>

të legjislacionit dhe politikave ekzistuese për arsimin parauniversitar dhe as që është hartuar ndonjë plan për zhvillimin e legjislacionit të ri. Ndonëse në fillim të vitit 2016 është hartuar Ligji për Inspektoratin e Arsimit, i njëjti nuk i ka kaluar procedurat e shqyrtimit në Kuvendin e Kosovës. Tani, ky ligj duhet t'i shtrohet procedurës së sërishme të shqyrtimit nga Qeveria, për të vazhduar pastaj shqyrtimi i tij në Kuvendin e Kosovës.

Gjatë vitit 2017 është punuar edhe në Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, të inicuar në vitin 2011 nga Kuvendi i Kosovës. Në versionin aktual të projektligjit parashihet që punonjësit e arsimit që kanë punuar prej 1 deri në 5 vjet gjatë periudhës 1990/91-1998/99 të gëzojnë pensionin e pleqërisë në lartësi prej 65% të pagës bazë në arsimin fillor, ndërsa ata që kanë punuar më gjatë se 5 vjet në lartësi prej 75% të pagës bazë në arsimin fillor. Po ashtu, parashihen beneficione të tjera që kanë të bëjnë me shërbime shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.

#### 4.2.6 Mjediset shkollore – siguria dhe infrastruktura

Në kuadër të synimit për të krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë nëpër shkolla, nga MASHT dhe DKA-të janë ndërmarrë disa hapa, ndonëse mund të konsiderohen të pamjaftueshme. Në këtë fazë kuptohet se MASHT ka formuar grupin punues i cili do të punojë në hartimin e Udhëzimit Administrativ për ushqimin e shëndetshëm në shkolla.

Gjithashtu kuptohet se janë realizuar aktivitete të ndryshme në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të shkollave dhe DKA-ve në parandalimin e dhunës. Gjatë vitit shkollor 2016/2017, në SMIA janë regjistruar 43 raste të dhunës në shkolla. Me qëllim të vetëdijesimit të stafit shkollor për rëndësinë e raportimit të dhunës, gjatë vitit 2017, janë zhvilluar dy trajnime për zbatimin e Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, ku janë përfshirë 20 shkolla nga 9 komuna. Në po këto 20 shkolla, do të krijohen grupet e ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve, të cilat do të ndihmojnë shkollën në zgjidhjen e konflikteve në mes bashkëmoshatareve. Procesi do të vazhdojë me trajnimin e zyrarëve të DKA-ve për shfrytëzimin e Modulit për raportimin e dhunës që është pjesë e SMIA-s gjatë muajve tetor dhe nëntor 2017.

Procesi i krijimit të mjediseve të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë nëpër shkolla ka ngecje të theksuara. Për shembull, në asnjë shkollë ende nuk është mbajtur ndonjë trajnim për shëndet dhe siguri dhe nuk janë pajisur 300 shkolla me komplete të ndihmës së parë, ashtu siç pritej për këtë vit.<sup>49</sup>

Sipas të dhënave nga MASHT, Departamenti i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Teknike, deri në momentin e raportimit janë ndërtuar tri objekte shkollore: në Batllavë/Podujevë, në Duhël/Suharekë dhe në Fushë Kosovë. Pritet që deri në fund të vitit kalendarik të përfundojnë edhe dy objekte të tjera shkollore: shkolla model në Mitrovicë dhe shkolla në Qirez/Skenderaj, duke realizuar planin e paraparë në PSAK 2017 në ndërtimin e pesë shkollave të reja në tërë Republikën e Kosovës<sup>50</sup>.

MASHT dhe Komisioni Evropian kanë bashkëpunuar ngushtë në ndërtimin e çerdheve të parapara për vitin 2017. Kështu nga buxheti i përbashkët MASHT dhe IPA 2016 është kontraktuar ndërtimi i tri çerdheve, ndërsa ndërtimi i një çerdheje tjetër i është bartur MAP. Bëhet fjalë për ndërtimin e çerdheve në Shtime, Kaçanik, Rahovec dhe Prizren. Këto

49 Email nga Fadile Dyla – Udhëheqëse e Departamentit të Infrastrukturës MASHT, 20 tetor 2017  
50 Po aty.

projekte janë të planifikuara të përfundohen në vitin 2018<sup>51</sup>. Për shkak të obligimeve të kontraktuara për ndërtimin e shkollave MASHT ka pasur projekte të kufizuara në renovimin e shkollave. Ndër tri projektet e vetme të renovimit të shkollave, vetëm në njërin prej tyre ka përfunduar renovimi, në një tjetër vazhdon renovimi dhe e treta është në përsëritje të procedurave të publikimit. MASHT nuk ka informacione nga komunat për numrin e objekteve të renovuara nga vet komunat.<sup>52</sup>

Gjatë vitit 2017 janë pajisur me inventar shkollor gjithsej 13 shkolla. Ndërkaq, me pako sportive janë pajisur shtatë salla të sportit, derisa, për arsye të buxhetit të limituar, pa pajisje sportive kanë mbetur tri salla tjera.

# SIGURIMI I CILËSISË



51 Po aty.  
52 Po aty.



### 4.3. Objektivi 3: Sigurimi i cilësisë

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

#### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Janë bërë hapet e parë në ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. Janë emëruar 140 kordinatorë të cilësisë në shkollat fillore dhe të mesme, ndërsa, duke filluar nga janari i vitit 2018, është ndarë buxheti për 560 nga gjithsej 1,100 kordinatorë sa duhet t'i kenë shkollat e Kosovës. Megjithatë, procesi i emërimit të kordinatorëve ka elemente formalizmi, ndërkohë që disa nga kordinatorët e emëruar nuk janë në gjendje ta kryejnë detyrën e tyre për shkak të ngarkesave të tjera.

Janë krijuar parakushtet ligjore për vlerësimin e performancës së shkollës. Po ashtu, është zhvilluar metodologjia për vetvlerësimin e shkollës, e cila është pilotuar në 63 shkolla, si dhe metodologjia për vlerësimin e jashtëm, për të cilën janë trajnuar 16 inspektorë të arsimit.

Është nxjerrë udhëzimi administrativ për punën e aktiveve shkollore dhe ka filluar të zbatohet në shkollat ku pilotohet kurrikula e re. Në mungesë monitorimi nuk mund të thuhet asgjë për efektivitetin e funksionimit të aktiveve sipas konceptit të ri.

Në 10 nga 36 komuna janë hartuar plane zhvillimore komunale të arsimit, ndërsa në 140 shkolla janë hartuar plane zhvillimore të shkollës. Të gjitha këto janë arritur me mbështetjen e projekteve të financuara nga donatorët.

Nuk është ndërmarrë asnjë hap drejt themelimit të Agjencisë për Kurrikulum, Vlerësim dhe Standarde, përkundër faktit se kjo agjenci parashihet me ligjin e vitit 2011.

Me mbështetjen e projektit ESIP ka filluar procesi i ndërtimit të sistemit për dhënien e informatës kthyesë komunave dhe shkollave, hartimi i udhëzuesit të ri për administrimin dhe monitorimin e testeve dhe krijimi i bankës së pyetjeve me karakteristika të plota të pyetjeve.

Administrimi i testeve kombëtare mbetet pikë e dobët e zbatimit efektiv të tyre. Edhe këtë vit, MASHT nuk ka ndërmarrë hapa radikalë për përmirësimin e administrimit.

#### 4.3.1. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë

Ashtu siç pritej për vitin 2017, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) me ndihmën e UNICEF ka zhvilluar një metodologji për vetvlerësimin e shkollave<sup>53</sup>, e cila është zbatuar në 63 shkolla ku pilotohet kurrikula e re. Në gushtin e vitit 2017 është aprovuar Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar<sup>54</sup> i cili përcakton metodologjinë e vlerësimit, si dhe procedurat për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm. Sipas këtij udhëzimi, procesi i vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, realizohet nga ekipi me bazë në shkollë, duke u bazuar në fushat e cilësisë dhe në Planin zhvillimor të shkollës.<sup>55</sup> Nga secila shkollë janë trajnuar për vetvlerësim drejtori dhe një anëtar tjetër i personelit, ndërsa raportet e vetvlerësimit janë dërguar nga shkollat në IPK, i cili ka dhënë informatë kthyesë në lidhje me to. Është në proces ndërtimi i kapacitetit në IPK për t'i sistemuar këto raporte në atë mënyrë që të nxirren përfundime për intervenimet e nevojshme në sistemin e arsimit. Ky proces mbështetet nga KulturKontakt-Austria.<sup>56</sup>

Në kuadër të ngritjes së cilësisë në arsim, për vitin 2017 plani i veprimit gjithashtu parasheh kryerjen e vlerësimeve të jashtme të shkollave nga inspektorët, si dhe mbështetjen në vlerësimet e jashtme shkollore. Deri në shtator 2017, kur janë mbledhur të dhënat për këtë pjesë të raportit, këto aktivitete janë në proces të realizimit, mirëpo me vonesë. Në vitin 2016, IPK ka trajnuar 16 inspektorë të arsimit për vlerësim të jashtëm të shkollave dhe, me të përfunduar të trajnimit, metodologjia është pilotuar në 7 shkolla. Pas pilotimit është finalizuar udhëzuesi për vlerësim të jashtëm<sup>57</sup>.

Siç parasheh plani i veprimit për vitin 2017, manuali për menaxhimin e cilësisë është hartuar nga Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe është publikuar në janarin e vitit 2017. Ky manual shërben si bazë për trajnimin e kordinatorëve të cilësisë në shkolla që realizohet nga IPK si dhe për punën e kordinatorëve të cilësisë në shkolla. Detyra e kordinatorit të cilësisë është përshkruar në UA 2016/12<sup>58</sup>. Sipas UA 24/2016, në shkollat me më pak se 150 nxënës detyrën e kordinatorit të cilësisë e kryen vet drejtori, ndërsa në shkollat tjera drejtori emëron njërin nga punonjësit. Po ashtu, UA përcakton ngarkesën me punë të kordinatorit të cilësisë varësisht nga numri i nxënësve, kriteret që duhet t'i përmbushë kordinatori dhe jep një përshkrim të plotë të detyrave të punës të kordinatorit.

Plani i veprimit për vitin 2017 parasheh emërimin e kordinatorëve të cilësisë në 1,100 shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës. Deri në gusht të vitit 2017 janë emëruar gjithsej 140 kordinatorë të cilësisë në institucionet e arsimit parauniversitar të Kosovës, ndërsa me KASH 2018-2020<sup>59</sup> është siguruar buxheti për 560 kordinatorë të cilësisë duke filluar nga viti 2018. Raportet nga terreni tregojnë se emërimi i kordinatorëve të cilësisë, shpesh, karakterizohet me formalizëm, pa e kuptuar mirë rolin që duhet ta ushtrojë personi i tillë. Ka raste kur në këto pozita emërohen mësimdhënës të cilët nuk kanë normë të plotë të orëve mësimore.

Për shembull, në shkollën “Ismail Qemali”<sup>60</sup> është emëruar mësimdhënësi i kimisë si kordinator i cilësisë, mirëpo edhe pse ka marrë pjesë në trajnime për këtë detyrë, sipas drejtoreshës, ai nuk ia del t'i përmbushë obligimet në nivel të duhur në shkollë. Kjo ndodhë, kryesisht, pasi mësimdhënësi nuk është shkarkuar nga orët mësimore, dhe kjo e

53 <http://ipkmasht.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-brendshem-te-shkolles/>  
54 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-ar-simin-parauniversitar-rotated.pdf>  
55 Po aty .  
56 [http://www.kulturkontakt.or.at/html/D/wp.asp?pass=x&p\\_lcd=de&p\\_title=5452&rn=179122](http://www.kulturkontakt.or.at/html/D/wp.asp?pass=x&p_lcd=de&p_title=5452&rn=179122)  
57 Udhëzues për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, IPK, 2017.  
58 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>  
59 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FO499CD8-DB8B-48A0-9B2B-F313CB114E67.pdf>  
60 Intervistë me Hatmane Demiri, drejtoreshë e shkollës “Ismail Qemali” Prishtinë, 06.10.2017.

vështirëson përqendrimin e tij në detyrat e koordinatorit, të cekura më lartë. Shembuj të ngjashëm të mos-shkarkimit të koordinatorëve të cilësisë nga detyrat mësimore ka edhe në shkollën “Xhemajl Mustafa” në Prishtinë<sup>61</sup> dhe “Selman Riza” në Fushë Kosovë.<sup>62</sup>

Një shembull i mirë i zbatimit të UA të lartpërmendur është shkolla “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë. Në bazë të numrit të madh të nxënësve, mbi 2,400, në këtë shkollë, në shtator 2017, koordinatorë e cilësisë është emëruar një mësimdhënëse klasore, e cila është shkarkuar tërësisht nga pozita e mësueses dhe tani ushtron vetëm detyrën e koordinatorës së cilësisë në nivel shkolle. Përzgjedhja e saj si koordinatorë e cilësisë, po ashtu, ka përcjellë kriteret e përcaktuar nga UA, pasi që ajo ka ndjekur trajnimet adekuate, ndonëse sipas saj ish-in të përsheptuara dhe jo mjaftueshëm efektive. Me të marrë detyrën e saj, koordinatorja e cilësisë është fokusuar në fuqizimin e aktiveve profesionale brenda shkollës. Aktivitetet profesionale si ai i gjuhëve, i shkencave shoqërore, shkencave natyrore, i matematikës dhe TIK, i shkathtësive, si dhe i mësimdhënësve të ciklit të ulët kanë funksionuar mjaft mirë në këtë shkollë edhe në mungesë të koordinatorës së cilësisë. Megjithatë, sipas koordinatorës së cilësisë, ende ka hapësirë për përmirësim dhe fuqizim të tyre, sidomos në fuqizimin e rolit të udhëheqësit të secilit aktiv si dhe të bashkëpunimit më të ngushtë të anëtarëve të aktivitetit përmes takimeve më të shpeshta. Mirëpo në këtë fazë fillestare të ushtrimit të detyrës së re, ajo has në shumë vështirësi, duke filluar nga mungesa e hapësirës së punës-zyrës, mjeteve të punës-laptopit, si dhe mungesës së materialeve shpenzuese që duhej të siguroheshin nga DKA.<sup>63</sup> Shembull tjetër i mirë është në SHFMU “Zenel Hajdini” në Prishtinë, ku koordinatori i cilësisë, i zgjedhur në shtator 2017, është liruar nga 8 orë të rregullta mësimi, duke përcjellë kriteret e përcaktuara nga UA. Koordinatori i cilësisë së kësaj shkolle gjithashtu është udhëheqës i ekipit të vlerësimit të performancës së brendshme të shkollës.<sup>64</sup>

Në bazë të të dhënave të grumbulluara deri në shtator 2017, konstatohet se emërimi i udhëheqësve të aktiveve në shkolla, i cili ishte paraparë në planin e veprimit për këtë vit, është realizuar pjesërisht. UA i MASHT Nr. 22/2016 për aktivitetet (departamentet) profesionale të shkollave është miratuar në nëntor të viti 2016<sup>65</sup>. UA obligon shkollat që të formojnë aktive sipas fushave lëndore të Kurrikulës së Re. Po ashtu përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së udhëheqësve të aktiveve. Aktivitetet e tilla janë formuar në shkollat ku zbatohet kurrikula e re, ndërsa në shkollat tjera vazhdon funksionimi i aktiveve profesionale sipas sistemit të deritanishëm. Megjithatë, nga shtatori i vitit 2017, të gjitha shkollat, gradualisht do të kalojnë në sistemin e ri, prandaj edhe organizimi i aktiveve do të jetë në përputhje me rregullativin e ri. Këtu duhet theksuar se UA vetëm sanksionon dhe saktëson një praktikë shumëvjeçare të funksionimit të aktiveve profesionale në shkolla, por jo medoemos, ndryshon praktikën e funksionimit të tyre. UA nuk parasheh asnjë kompensim për udhëheqësit e aktiveve, përderisa emërimi i tyre bëhet nga drejtori i shkollës. Kjo paraqet rrezik që puna e aktiveve të karakterizohet me formalizëm.

UA 22/2016<sup>66</sup> e parasheh krijimin e aktiveve të përbashkëta të disa shkollave (“komunitetet e të nxënësve bashku”) dhe në nivel komune. Grupe të tilla në nivel komune janë krijuar nga DKA – Prishtinë dhe DKA-Gjakovë, por ka raportime për pengesa serioze në funksionimin e tyre, për shkak të mospagesës dhe koordinimit jo të duhur. Emërimi i koordinatorëve të cilësisë në komuna, siç ishte paraparë në planin e veprimit, në bazë të të dhënave të grumbulluara deri në shtator 2017, është realizuar pjesërisht. Deri më tani nuk kemi të dhëna nëse të gjitha komunat kanë emëruar koordinatorë të cilësisë, por janë në dijeni se një numër i konsiderueshëm i tyre e kanë bërë këtë. Megjithatë, duhet theksuar se koordinatorë

61 Intervistë me Shpresa Shalën, drejtoreshë e shkollës “Xhemajl Mustafa” Prishtinë, 06.10.2017.  
62 Intervistë me Ruzhdi Krasniqin, koordinator i cilësisë dhe arsimtar i gjuhës angleze në shkollën “Selman Riza” në Fushë Kosovë, 18.10.2017.  
63 Intervistë me Mimoza Kryeziun, koordinatorë e cilësisë në SHFMU “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë, 18.10.2017.  
64 Intervistë me Shkurta Krasniqin, zëvendës-drejtoreshë në SHFMU “Zenel Hajdini” Prishtinë, 19.10.2017.  
65 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>  
66 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>

të cilësisë, rëndom, emërohen zyrtarët komunalë të arsimit që kanë edhe angazhime të tjera në DKA, gjë që ndikon që këtë detyrë të mos e marrin me prioritet. Gjatë intervistës në DKA të Fushë Kosovës<sup>67</sup> kuptohet se në këtë komunë janë emëruar dy koordinatorë të cilësisë. Ata bëjnë vizita të rregullta nëpër shkolla dhe bashkëpunojnë me koordinatorët e cilësisë në nivel të shkollave.

Plani i veprimit për vitin 2017 parasheh caktimin e inspektorëve arsimorë për vlerësim të jashtëm të shkollave, caktimin e inspektorëve arsimorë për licencimin e mësimdhënësve si dhe caktimin/ e inspektorëve për inspektim administrativ, mirëpo deri në dhjetor 2017, Projektligji për Inspektoratin e Arsimit i përgatitur në fillim të vitit 2016 nuk është aprovuar në Kuvend.<sup>68</sup> Si rezultat, nuk është bërë ndarja formale e detyrave të inspektorëve, në përputhje me ligjin. Inspektorët vazhdojnë të jenë të ndarë sipas rajoneve gjeografike dhe me detyra të përgjithshme, por disa prej tyre janë përfshirë në pilotimin e vlerësimit të jashtëm të shkollave, si dhe në pilotimin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve që nuk do të thotë se do të vazhdojnë t'i ushtrojnë këto detyra.

Një aktivitet tjetër i paraparë në planin e veprimit për vitin 2017 ishte edhe ofrimi i të dhënave nga monitorimi në dispozicion të DKA-ve dhe shkollave me qëllim të shfrytëzimit të tyre, mirëpo, sipas të dhënave, deri në aprovimin e Ligjit të ri, inspektorët e arsimit kryejnë vizita rutinore në shkolla dhe raportet e inspektimit ndahen vetëm me DKA-të. Pasi që ky aktivitet ka të bëjë me raportet e vlerësimit të jashtëm, i cili ndodhet në fazë shumë të hershme të zbatimit, nuk mund të thuhet se ka pasur ndonjë progres. Nga të dhënat e grumbulluara në shkollën “Ismail Qemali”<sup>69</sup> kuptohet se në këtë shkollë ka vizita rutinore nga inspektorët e arsimit, të cilët bëjnë monitorimin e orëve mësimore (gjithsej 8 klasë janë monitoruar gjatë vitit shkollor 2016/2017), shqyrtojnë dokumentacionin e drejtorit dhe personelit psiko-pedagogjik dhe administrativ, por përqendrohen fare pak në cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu ata ofrojnë fare pak informata kthyesë për udhëheqësinë e shkollës dhe kjo u pamundëson atyre të bëjnë përmirësimet e duhura. Në të kundërtën, Shpresa Shala thekson se në shkollën “Xhemajl Mustafa” nuk ka pasur asnjë vizitë apo monitorim nga ana e inspektorëve të arsimit gjatë kohës së mandatit të saj si drejtor shkolle, që nga gushti i vitit 2015.

#### 4.3.2. Planifikimi zhvillimor i shkollës

Ashtu siç është paraparë në planin e veprimit për vitin 2017, është rishikuar udhëzuesi “Plani zhvillimor i shkollës dhe menaxhimi i projektit” (Moduli 4) nga një grup pune i formuar nga GiZ CDBE. Udhëzuesi i rishikuar tanimë ka filluar të shfrytëzohet nga shkollat për hartimin e planeve zhvillimore dhe është në përputhje me UA të ri 23/2016<sup>70</sup> për planin zhvillimor të shkollës dhe planin komunal, i cili e përcakton procedurën e re për hartimin dhe aprovimin e këtyre planeve. UA përcakton formatin e planit zhvillimor, ndërkaq, instrumentet janë dhënë në shtojcë të UA<sup>71</sup>. Me UA përcaktohet 31 marsi si afat për hartimin/rishikimin e planeve zhvillimore të shkollave.

Projekti KEEN i financuar nga Bashkimi Evropian ka ndihmuar hartimin e planeve zhvillimore 5-vjeçare në shtatë komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Gjiçan, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë dhe Pejë. Ndërkaq, GiZ CDBE ka mbështetur hartimin e planeve zhvillimore komunale në Kaçanik, Klinë dhe Fushë-Kosovë. Këto plane reflektojnë nevojat zhvillimore të komunave në fushën e arsimit dhe janë në harmoni me PSAK-un.

Deri në shtator të vitit 2017, projekti ESIP i zbatuar nga MASHT dhe i financuar nga kredia e Bankës Botërore, në kuadër të nën komponentit 1.3 - Grantet për Zhvillimin e Shkollave, ka përkrahur 140 shkolla, të përzgjedhura si përfituese

67 Intervistë me Islam Shabanin, drejtor i Arsimit në Fushë Kosovë, 16.10.2017.  
68 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-114.pdf>  
69 Intervistë me Hatmane Demiri, drejtoreshë e shkollës “Ismail Qemali” Prishtinë, 06.10.2017.  
70 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf90.pdf>  
71 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/23-shtojce-e-ua-23-2016-pzshsh-dhe-pzhak-final-30102016pdf-pjesa-2.pdf>

të granteve, në hartimin e planit zhvillimor të shkollës. Megjithatë, nga gjithsej 24 komuna të cilat do të përfitojnë nga këto grante, nga terreni, është vërejtur se një numër shumë i vogël i komunave kanë të fuqizuar qasjen e integruar të planifikimit edhe pse janë të njoftuara për një qasje të tillë. Në përgjithësi është vërejtur se bashkëpunimi MASHT – DKA – Shkollë në shumicën e komunave është i mangët.

Ndonëse është paraparë që në vitin 2017 të zhvillohet korniza për monitorimin e zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave, ajo nuk është realizuar. Megjithatë, edhe në mungesë të kësaj kornize një lloj vlerësimi i jashtëm i planeve zhvillimore gjatë vitit 2017 do të bëhet nga projekti “Grantet për Zhvillimin e Shkollave”.

#### 4.3.3. Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë

Në kuadër të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve për inspektorë të arsimit, janë organizuar trajnime për vlerësim të performancës së shkollës, të realizuara në periudhën tetor 2016 - maj 2017, të cilat do të vazhdojnë deri në dhjetor 2017. Në këto aktivitete janë përfshirë 16 inspektorë të arsimit. Hartimi i doracakut për aktivitetet e shkollave dhe organizimi i sesioneve informuese në shkolla/komuna ishin paraparë në planin e veprimit për vitin 2017, mirëpo të dhënat e mbledhura deri në shtator 2017 tregojnë se ato nuk janë realizuar. Përveç UA të MASHT Nr. 22/2016 për aktivitetet (departamentet) profesionale të shkollave, që është miratuar në nëntor të vitit 2016, nuk ka ndonjë doracak specifik për punën e aktiveve profesionale. Përndryshe, disa udhëzime të përgjithshme për rolin e tyre në zbatimin e kurrikulës së re jepen në “Udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë”,<sup>72</sup> publikim i IPK i vitit 2016, por kjo nuk paraqet zëvendësim për udhëzimet specifike që kanë të bëjnë, drejtpërdrejt, me funksionimin ditor të aktiveve.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara për qëllim të këtij raporti, deri në shtator 2017, janë realizuar disa aktivitete të parapara për vitin 2017 për ngritjen e kapaciteteve të shkollave për menaxhim të cilësisë. Projekti i Binjakëzimit (Twinning) i financuar nga Bashkimi Evropian ka bërë trajnimin e rreth 200 koordinatorëve të cilësisë nga shkolla anekënd Kosovës. Në trajnim janë përfshirë edhe 35 drejtorë të shkollave dhe 24 koordinatorë të cilësisë të nivelit komunal. Trajnimi është mbajtur nga trajnerë të IPK duke u bazuar në manualin për menaxhimin e cilësisë të hartuar nga Projekti i Binjakëzimit.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të grupeve profesionale komunale, sipas të dhënave të mbledhura në shtator 2017, nuk ka pasur progres në këtë drejtim. Roli i këtyre grupeve është që t'i mbështesin shkollat në zbatimin e kurrikulës së re dhe fakti që ato grupe nuk funksionojnë si duhet paraqet sfidë për zbatimin e kurrikulës së re. Kjo mbështetet nga të dhënat e mbledhura në shkollën “Ismail Qemali”<sup>73</sup> ku kuptohet se përveç trajnimit të pamjaftueshëm për kurrikulën e re, mësimdhënësit ndjehen të pa-përgatitur dhe të pa-përkrahur në zbatimin e saj në orët mësimore.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor, siç ishte paraparë në planin e veprimit për 2017, trajnimet për planifikimin zhvillimor të shkollës kanë vazhduar, qoftë në kuadër të programit të GiZ CDBE për udhëheqje arsimore, qoftë si aktivitete të veçanta. Një ndër aktivitetet e veçanta është organizuar në kuadër të projektit “Grantet Zhvillimore të Shkollave” ku në trajnim për PZhSH janë përfshirë 280 përfaqësues të 140 shkollave, të cilat po ashtu janë ndihmuar që t'i hartojnë planet zhvillimore 3-vjeçare. Në trajnime të tilla kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e DKA.

<sup>72</sup> <http://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/Udhezuesi-per-zbatim-te-kurrikules1.pdf>  
<sup>73</sup> Intervistë me Bajram Vrapçanin, zëvendësdirjtor në shkollën “Ismail Qemali” Prishtinë, 06.10.2017

Në raport me themelimin e Agjencisë për Kurrikulë, Vlerësim dhe Standarde, të dhënat e mbledhura deri në shtator 2017 tregojnë se nuk ka pasur asnjë progres në këtë drejtim. Është për t'u habitur se si përmbushja e një obligimi ligjor zvarritet nga një vit në vitin tjetër ndërkohë që kjo agjenci mbulon fushat më të ndjeshme të sistemit të arsimit, prej të cilave varet drejtpërdrejt cilësia e rezultateve të të nxënësve.

#### 4.3.4. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve

Sistemi kombëtar i vlerësimit gëzon mbështetjen e projektit ESIP të financuar nga kredia e Bankës Botërore, dhe realizon disa aktivitete të parapara nga plani i veprimit për 2017. Për të mbështetur përmirësimin e këtij sistemi janë ndarë 3 mil. USD dhe me këtë shumë mbulohet zbatimi i sistemit për dhënien e informatës kthyesë komunave dhe shkollave, hartimi i udhëzuesit të ri për administrimin dhe monitorimin e testeve dhe krijimi i bankës së pyetjeve me karakteristika të plota të pyetjeve. Njësia për Vlerësim dhe Standarde është në fazën e përzgjedhjes së kompanisë ndërkombëtare e cila do të ofrojë mbështetje profesionale për adresimin e këtyre çështjeve. Si duket, varësia nga ekspertiza ndërkombëtare është aq e madhe sa nuk është bërë asnjë progres domethënës në asnjërin nga këto aktivitete. Në këtë drejtim, nuk është realizuar as publikimi i shembujve të praktikave të mira dhe sukseseve në portalin e sigurimit të cilësisë, dhe as ndarja e mirënjohjeve për praktika të mira, të cilat janë paraparë në planin e veprimit në 2017. Portali për sigurimin e cilësisë nuk ekziston dhe as që ka pasur ndonjë formë të organizuar të ndarjes së praktikave më të mira të sigurimit të cilësisë.

Në planin e veprimit për vitin 2017 është paraparë përgatitja e materialeve promovuese për informimin e prindërve si dhe realizimi i fushatës informuese në media elektronike, por në bazë të të dhënave të mbledhura deri në shtator, 2017, nuk janë realizuar as këto aktivitete. Po ashtu, nuk ka pasur asnjë fushatë që synon prindërit.

Organizimi i konferencës vjetore për sigurimin e cilësisë është një aktivitet shumë i rëndësishëm i parapara nga PSAK, por deri në fund të vitit 2017 ajo nuk është mbajtur. Në fakt, konferenca e fundit e tillë ka qenë në fund të vitit 2015.

Rezultati i testeve kombëtare që zbatohen në kuadër të sistemit të arsimit në Kosovë mund të shërbejë si pasqyrë e nivelit të cilësisë në arsimin parauniversitar, me kusht që rezultati të jetë i besueshëm dhe i bazuar në dijen e nxënësve. Prandaj, ashtu siç parashihet në Planin e Veprimit të PSAK, është hartuar udhëzuesi i ri për administrimin dhe monitorimin e testeve. Mirëpo, në kuadër të hartimit të programit për trajnim të administruesve dhe monitoruesve të testeve këtë vit janë realizuar vetëm sesione informimi të administruesve që zgjasin rreth 2 orë dhe nuk e kanë karakterin e trajnimit.

Administrimi vazhdon të jetë pika më e dobët e menaxhimit të testeve kombëtare. MASHT<sup>74</sup> tregon se DKA-të kanë caktuar administruesit e testeve, të cilët janë informuar nga MASHT rreth detyrave të tyre. Administruesve gjithashtu u është shpërndarë nga një UA për administrim të testeve, në mënyrë që të kenë më të qartë se çfarë përfshihet në rolin e tyre si administrues. Gjithashtu, edhe në vitin 2017 janë ftuar mediat dhe organizatat e shoqërisë civile që ta monitorojnë provimin e maturës. Raportet e tyre kanë qenë shumë kritike, por kjo nuk ka ndihmuar që testi të jetë më i besueshëm.

<sup>74</sup> Intervistë me Mustafë Kadriun, Udhëheqës i Divizionit për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, MASHT, 28.09.2017.



Suksesi mesatar në testin e arritshmërisë, i cili mbahet në fund të klasës së nëntë ka qenë 58 pikë në qershorin e vitit 2017, që paraqet rënie në raport me mesataren e qershorit të vitit 2016 – 64.7 pikë.<sup>75</sup> Ndërkaq, kalueshmëria në testin e maturës është shumë më e madhe në vitin 2017 – 83.5%<sup>76</sup>, në raport me vitin 2016 – 53.9%<sup>77</sup>. Rezultatet e tilla flasin për nevojën që të punohet në përmirësimin e administrimit dhe në standardizimin e mëtutjeshëm të testeve.

Pas publikimit të rezultateve të testit PISA për vitin 2015 (shih kapitulli 2 të këtij raporti), MASHT ka formuar një grup pune me qëllim që t'i analizojë shkaqet e rezultatit të dobët dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në sistemin e arsimit<sup>78</sup>. Ky hap nuk ka dhënë rezultate, pasi nuk është siguruar buxheti për hulumtimet që ka propozuar Grupi i Punës. Nga fundi i vitit 2017 është formuar grupi i ri i punës për PISA, që ka detyrë primare përgatitjet për testin PISA të vitit 2018, përfshire sensibilizimin e nxënësve që “të japin maksimumin e njohurive të fituara dhe të dalin me rezultat sa më të mirë”<sup>79</sup>.

Megjithatë, me përkrahjen e projektit ESIP është hartuar në raport kombëtar i testit PISA, i cili akoma është në formë drafti. Raporti sjell rekomandime për përmirësimin e gjendjes në sistemin e arsimit, duke vënë theksin në nevojën e përmirësimit të shkathtësive të leximit.

# ZHVILLIMI MËSIMDHËNËSVE



75 Informatë nga DSMV i MASHT.  
76 <http://masht.rks-gov.net/article/rezultatet-e-provimit-te-matures-shteterore-2017-afati-i-qershorit>  
77 <http://masht.rks-gov.net/article/kqsh-m-shpalli-rezultatet-e-testit-te-matures-kalueshmeria-539-perqind>  
78 <http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/masht-planifikon-disa-hulumtime-ne-terren-para-testit-pisa-2018/>  
79 <http://masht.rks-gov.net/article/masht-intensifikon-pergadatjet-per-testin-nderkombetar-pisa2018>

## 4.4. Objektivi 4: Zhvillimi i mësimdhënësve

**Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.**

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Përkundër aprovimit të akteve juridike dhe politikave që rregullojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve, këtij procesi akoma i mungon koordinimi i mirëfilltë dhe mbështetja në analizë të nevojave, Përzgjedhja e trajnimeve, në masë të madhe, varet nga perceptimet e zyrtarëve të MASHT dhe DKA-ve, si dhe nga prioritetet e donatorëve.

Gjatë vitit 2017 përqendrimi kryesor ka qenë në trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, ku janë përfshirë mbi 9,300 mësimdhënës. Ndërkaq, nuk janë mbajtur trajnime specifike për zbatim të kurrikulave sektoriale dhe kornizave të profileve të AAP.

Procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve akoma nuk ka filluar. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë plan i qartë veprimi për zhvillimin e këtij procesi në të ardhmen, përkundër faktit se është punuar në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe trajnimin e inspektorëve.

Licencimi i mësimdhënësve bëhet vetëm për nivelin e licencës së karrierës, ku nuk kërkohet vlerësimi i performancës. Edhe pse ishte paraparë në planin e veprimit të PSAK 2017 hartimi i UA për harmonizimin e gradave me sistemin e pagave nuk është realizuar, për shkak të mungesës së buxhetit. Rritja e pagave vazhdon të bëhet në mënyrë lineare.

Nga të dhënat e Fakultetit të Edukimit del se është shtuar numri i nxënësve të shkëlqyeshëm që regjistrojnë studimet në këtë Fakultet. Në vitin akademik 2017/18, 70% e të regjistruarve janë nxënës të shkëlqyeshëm.

### 4.4.1. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të realizimit të reformës arsimore është parakusht për ngritjen cilësisë së mësimdhënies. Gjatë vitit 2017, MASHT ka hartuar pakon ligjore që mundëson mbarëvajtjen e procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Brenda vitit janë nxjerrë tri udhëzime administrative që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e mësimdhënësve: UA 3/2017 për Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM)<sup>80</sup>, UA 5/2017 - Sistemi i licencimit dhe zhvillimit në karrierë të mësimdhënësve<sup>81</sup>; UA 6/2017 - Kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë<sup>82</sup>.

Në prillin e vitit 2017 është aprovuar Korniza për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM)<sup>83</sup>, e cila përcakton standardet për profesionin e mësimdhënësit, përfshirë përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, fazën fillestare të ushtrimit të profesionit, dhe zhvillimin në karrierë. Po ashtu, Korniza për ZHPM përcakton kompetencat në faza të ndryshme të karrierës dhe shërben si orientim për organizimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në këto faza. Profili i kompetencave të mësimdhënësit përbëhet nga 7 standarde, të cilat përcaktojnë se çfarë duhet të dijë dhe të bëjë një mësimdhënës. Ndërkaq, standardet përmbledhen në katër grupe: vlerat profesionale, njohuria profesionale dhe të kuptuarit, praktika profesionale dhe mësimdhënja, dhe përkushtimi profesional.

Në Kosovë ende nuk funksionon një sistem për identifikim të nevojave për zhvillim profesional në nivel shkolle, përpunim të këtyre të dhënave në nivel të komunave dhe organizim të trajnimeve sipas nevojave të mësimdhënësve. Për këte arsye, trajnimet mbahen, kryesisht, bazuar në perceptimin e MASHT dhe DKA-ve, si dhe në varësi nga programet e donatorëve. Edhe pse ekziston UA për financimin e ZHPM, nuk është hartuar ende një kornizë e cila do të përcaktonte qartë se si do të mund të realizohej një financim i qëndrueshëm për ZHPM, i cili do të mundësonte realizimin e procesit të licencimit të mësimdhënësve. Kompleksiteti i koordinimeve brenda institucioneve qeveritare ka bërë që hartimi i kornizës të shtyhet për më vonë.

Ndarja e buxhetit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve ka qenë, deri diku, sfiduese në vitin 2017. MASHT ka bërë sigurimin e materialeve të nevojshme gjatë trajnimeve që janë organizuar për aftësimin e mësimdhënësve për zbatimin e KKK, ndërsa organizatat që kanë realizuar trajnime të tjera për ZHPM kanë siguruar vet materialet e nevojshme. Edhe pse me plan të punës për PSAK 2017 është paraparë që, nga ana e komunave të bëhet furnizimi i Qendrave për Ngritje Profesionale (QNP) me materiale të nevojshme, si dhe të ngrihen 2 QNP të reja, një gjë e tillë nuk është bërë për shkak të kufizimeve buxhetore.

Divizioni për trajnime në MASHT ka realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ZHPM për vitin 2017. Gjatë këtij viti janë akredituar 13 programe të zhvillimit profesional, ndërsa mbi 9,300 mësimdhënës të nivelit parauniversitar kanë marrë pjesë në trajnime për zbatimin e KKK.

Duhet theksuar se asnjë program për shkollat profesionale nuk është sjellë për akreditim në zyrën për trajnime në MASHT. Po ashtu, nuk janë mbajtur trajnime specifike për zbatim të kurrikulave sektoriale dhe kornizave të profileve të AAP.

80 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/3-2017-ua-per-keshillin-shtetror-per-licencim-te-mesimdhenesveve.pdf>

81 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf>

82 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/6-2017-ua-per-kriteret-dhe-procedurat-e-aprovimit-te-programeve-per-zhvillim-profesional-te-mesimdhnesve-dhe-punonjesve-arsimor-rotated.pdf>

83 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>

#### 4.4.2. Licencimi i mësimdhënësve

Vlerësimi i mësimdhënësve është një proces i rëndësishëm në arsim. Ai i referohet procesit formal që një shkollë përdor për të shqyrtuar dhe vlerësuar performancën dhe efektivitetin e mësuesve në klasë. Në kushte ideale, gjetjet nga këto vlerësime përdoren për të siguruar trajnime për mësuesit dhe për të udhëhequr zhvillimin e tyre profesional. Ndonëse procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve është paraparë në planin e veprimit të PSAK 2017, të dhënat tregojnë se ai ende nuk ka filluar. Sipas Departamentit për Inspektim është duke u punuar për finalizim të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit të performancës. Nuk është bërë rishikim i veçantë i UA për vlerësim të performancës së mësimdhënësve, por rishikimi i disa pjesëve të UA së mëhershme, që është reflektuar brenda UA 5/2017<sup>84</sup> për sistemin e licencimit dhe zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë. Ndërsa është në proces finalizimi i doracakut me instrumente për vlerësim të performancës<sup>85</sup>.

Gjithashtu, siç ishte e paraparë dhe me plan të punës së PSAK, gjatë vitit 2017 është bërë trajnimi i inspektorëve lidhur me vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, mirëpo jo edhe i ndonjë vlerësuesi tjetër. Mos finalizimi i dokumenteve që mundësojnë vlerësimin e performancës së mësimdhënësve ka ndikuar që trajnimet për menaxhmentin e shkollës dhe informimet për mësimdhënësit dhe zyrtarët e tjerë të shtyhet për më vonë. Departamenti i Inspektoratit në MASHT akoma nuk ka një plan të veprimit për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

Në vitin 2017, MASHT, së bashku me Institutin Pedagogjik të Kosovës kanë filluar mbajtjen e trajnimit “Vlerësimi i brendshëm i shkollës”, në të cilin përfshihet edhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve. Vlerësimi i brendshëm i shkollës ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së shkollës, duke përfshirë kështu vlerësime nga shumë kënde, si ai i mësimdhënësit, drejtorit, nxënësve, prindërve, e komunitetit të gjerë. Udhëzuesi për vlerësimin e brendshëm të shkollës është në përputhje të plotë me<sup>86</sup> Udhëzimin Administrativ nr. 4/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.<sup>87</sup>

Në kuadër të funksionalizimit në tërësi të sistemit të licencimit të mësimdhënësve, MASHT ka hartuar planin e veprimit për organizimin e procesit të licencimit. Deri në periudhën e raportimit nuk janë mbajtur takime me mësimdhënës rreth licencimit, por planifikohen të mbahen shumë shpejtë. Gjatë vitit 2017 mbi 1,200 mësimdhënës kanë marrë licencën e karrierës.

Hartimi i UA për harmonizimin e gradave me sistemin e pagave nuk është realizuar, edhe pse ishte paraparë në planin e veprimit të PSAK 2017. Në përgjithësi, duket se nuk ekziston gatishmëria që të krijohet një ndërlidhje në mes të performancës së mësimdhënësit dhe pagës. Për këtë flet edhe vazhdimësia e rritjes së pagës për të gjitha kategoritë që paguhen nga Buxheti i Kosovës në përqindje fikse dhe të njëjtë për të gjithë.

84 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf>

85 <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/UDHEZUESI-PER-VETEVLERESIM1.pdf>

86 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>

87 Intervistë me Liridon Maliqin – Drejtor në shkollën “Qamil Batalli”, Prishtinë, 18 tetor 2017.

#### 4.4.3. Përgatitja e mësimdhënësve të rinj

Të dhënat e mbledhura në këtë fazë tregojnë se nuk janë hartuar standardet për pranimit të studentëve në fakultete arsimore, sepse konsiderohen të mjaftueshme kriteret e konkursit për regjistrim të tyre në fakultete arsimore.<sup>88</sup> Mirëpo, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, këtë vit në konkursin e pranimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2017/18 ka ngritur standardet e pranimit, duke arritur të kenë 70% të studentëve me notë të shkëlqyeshme. Kjo masë është marrë me vetiniciativë nga Fakulteti në Prishtinë, dhe jo si kërkesë e MASHT.

FE mohon se MASHT ka kërkuar nga fakulteti të bëjnë harmonizimin e programeve mësimore me KKK<sup>89</sup>. Ata theksojnë se asgjë nuk kërkohet nga MASHT kundrejt tyre, dhe se nuk e kanë asnjë përkrahje institucionale, përveç pagave për të cilat MASHT është e obliguar. Nga të dhënat e mbledhura kuptohet se nuk është organizuar asnjë trajnim për stafin e FE lidhur me hartimin dhe zbatimin e programeve sipas KKK.<sup>90</sup> Falë iniciativës dhe grantit të fituar nga projekti TEMPUS, FE në Prishtinë, këtë vit pret gjeneratën e dytë të programit të Masterit të Pedagogjisë për shkollat profesionale, program ky i akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

88 Intervistë me Majlinda Gjelaj, prodekane për çështje akademike në FA, Prishtinë, 18 tetor 2017.

89 Po aty.

90 Po aty.

# MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT



## 4.5. Objektivi 5: Mësimdhënia dhe të nxënit

**Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar burime mësimore të cilësisë së lartë.**

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Vendimi për zbatimin e kurrikulës së re në klasat 0, 1, 6 dhe 10 është marrë vetëm një muaj para fillimit të vitit të ri shkollor. Zbatimi filloi përkundër mungesës së teksteve mësimore dhe mjeteve të konkretizimit që janë në përputhje me kërkesat e kurrikulës së re. Nga shkollat raportohen vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e kurrikulës së re që janë pasojë e përgatitjeve të pamjaftueshme dhe mungesës së mbështetjes së vazhdueshme profesionale.

Monitorimi i zbatimit të kurrikulës së re vazhdon të jetë një çështje e pazgjidhur. Deri në shtatorin e vitit 2017 nuk është hartuar ndonjë plan monitorimi i cili sjell informata relevante për sfidat e zbatimit të kurrikulës dhe bën të mundur adresimin e sfidave të tilla.

Nuk është përcaktuar procesi i hartimit të teksteve të reja shkollore, nuk është shpallë konkursi për tekste të reja shkollore dhe as nuk janë pranuar dhe shqyrtuar propozimet nga shtëpitë botuese. Për më tepër, vazhdon të ketë dilema nëse tekstet shkollore do të hartohen nga botues vendorë, do të përkthehen nga gjuhë të huaja apo do të merren nga Shqipëria.

Është shënuar progres i kufizuar në nxitjen e shfrytëzimit të pajisjeve të TIK-ut në shkolla. Përveç furnizimit të shkollave me kompjuterë të rinj, nuk ka pasur aktivitete të koordinuara për instalimin e rrjeteve kompjuterike dhe ofrimin e qasjes në internet që do të jetë në funksion të mësimdhënies, si dhe instalimit të televizorëve SMART ose projektorëve në klasa. Po ashtu, kanë munguar aktivitetet për nxitjen e shfrytëzimit të materialeve elektronike për qëllime mësimore.

### 4.5.1. Zbatimi i kurrikulës së re

Në vitin shkollor 2017/18 filloi zbatimi i Kurrikulës së re të Kosovës, të bazuar në kompetenca, në të gjitha klasat 0, 1, 6 dhe 10. Edhe pse përgatitjet për këtë proces kanë filluar më herët, vendimi formal për shtrirjen e kurrikulës së re në klasat 0, 1, 6 dhe 10 në të gjitha shkollat e Kosovës është marrë vetëm një muaj para fillimit të vitit të ri shkollor, pa u bërë të njohura rezultatet e pilotimit disavjeçar dhe pa u bërë ndryshime në tekstet shkollore.

Në fakt, programet lëndore të zhvilluara paraprakisht janë shpërndarë në shkolla në gushtin e vitit 2016, pastaj ka filluar diskutimi dhe përdorimi i tyre në shkolla. Gjatë vitit shkollor 2016/17 për Kurrikulën e re janë trajnuar rreth 9,300 mësimdhënës të klasave 0,1,6 dhe 10. Gjatë ciklit të parë të trajnimit, të mbajtur në tetor – nëntor 2016, është ndarë një pyetësor me pjesëmarrësit në trajnime për të siguruar informata lidhur me programet dhe fillimin e përdorimit të tyre. Po ashtu, janë përgatitur tri raporte për MASHT – Divizionin e kurrikulave, të cilat janë përdorur për finalizimin e programeve për klasat 0,1,6 dhe 10. Si rezultat, këto programe janë miratuar në gusht 2017 dhe zbatohen nga shtatori 2017 në të gjitha shkollat<sup>91</sup>. Udhëzuesit për zbatim të kurrikulës për shtatë fushat mësimore të cilët u botuan në tetor 2016, janë rishikuar gjatë vitit 2017, ashtu siç ishte paraparë në planin e veprimit.

Shkolla “Xhemajl Mustafa”<sup>92</sup> ka qenë njëra nga shkollat në të cilat për 4 vitet e fundit është pilotuar kurrikula e re. Gjatë periudhës fillestare, sidomos në dy vitet e para, mësimdhënësit kanë hasur në vështirësi të shumta, përfshirë edhe mos-harmonizimin e kurrikulës me tekstet shkollore, mungesën e dokumentacionit pedagogjik, mungesën e programit mësimor dhe materialeve tjera mësimore për t’u përshtatur rezultateve, si dhe për t’i bërë ballë rezistencës për ndryshime dhe mungesës së udhëzimeve dhe përkrahjes nga MASHT për zbatimin e kurrikulës së re në shkollë.

Tani, pas katër vitesh, në vitin shkollor 2017/2018 kurrikula e re zbatohet në të gjitha nivelet e kësaj shkolle, përveç klasës së pestë, dhe drejtoresha e Shkollës, znj. Shpresa Shala mendon se mësimdhënësit qëndrojnë relativisht mirë në zbatimin e saj, ndonëse jo tërësisht në nivelin e dëshirueshëm. Kjo ndodh sepse disa mësimdhënës ende nuk i kanë tejkaluar vështirësitë në të kuptuarit e Kurrikulës së re. Gjithashtu znj. Shala potencon edhe mungesën e mjeteve të konkretizimit, vizitave studimore, dhe teksteve bazë. Sigurimi i materialeve është lënë në duart e mësimdhënësve dhe nuk ka metoda konkrete për të vlerësuar nëse mësimdhënësit posedojnë aftësitë dhe kompetencat e mjaftueshme për të vlerësuar mirë se çka i përmbush rezultatet e pritura në kurrikulën e re.

Intervistat në shkolla shpalosin shumë vështirësi nga ana e mësimdhënësve dhe drejtorëve në raport me trajnimin dhe zbatimin e kurrikulës së re. Për shembull, në shkollën “Ismail Qemali”, të gjithë mësimdhënësit e klasës së parë, gjashtë dhe të nivelit parashkollor kanë ndjekur trajnimin një-javor për kurrikulën e re në fund të gushtit 2017<sup>93</sup>. Mësimdhënësit shprehin pakënaqësi për trajnimin e pa-mjaftueshëm dhe udhëzimet jo të qarta për zbatimin e kurrikulës së re, shpeshherë të ofruara nga trajnerët, të cilët, sipas tyre, nuk kanë poseduar shkathhtësi të mjaftueshme për të bartur njohuritë në nivel adekuat gjatë trajnimeve. Si rezultat, mësimdhënësit kryesisht ndjehen të papërgatitur dhe të shqetësuar në lidhje me zbatimin e kurrikulës së re.

Për më tepër, mos-harmonizimi dhe mos-përshtatja e teksteve shkollore me kurrikulën e re e bën punën e mësimdhënësve edhe më të vështirë, pasi që ata detyrohen të bëjnë vetë përzgjedhjen e materialeve nga burime tjera për t’ia përshtatur planprogrameve sipas kurrikulës së re.

91 <http://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>

92 Intervistë me Shpresa Shalën, drejtoreshë e shkollës “Xhemajl Mustafa” Prishtinë, 06.10.2017.

93 Intervistë me Bajram Vrapçani, zëvendësdrejtor në shkollën “Ismail Qemali, Prishtinë, 06.10.2017.

Të njëjtat vështirësi dhe shqetësime në zbatimin e kurrikulës së re janë vërejtur edhe në shkollat tjera, si “Mihal Grameno”<sup>94</sup> dhe “Selman Riza”<sup>95</sup> në Fushë Kosovë, dhe “Zenel Hajdini”<sup>96</sup> në Prishtinë. Në shkollën “Mihal Grameno”<sup>97</sup> një shqetësim i veçantë është mungesa e materialeve të cilat nevojiten për shtypjen e planeve dhe materialeve për mësimdhënie, si rezultat i mungesës së materialit shpenzues. Me një numër të madh të nxënësve dhe mësimdhënësve kjo shkollë sistematikisht sfidohet me këtë problem, dhe përfiton fare pak mbështetje në materiale nga DKA. Ndonëse mungesa e materialeve është e pranishme edhe në SHFMU “Selman Riza”<sup>98</sup> në Fushë Kosovë, një lehtësim në zbatimin e kurrikulës është se kjo shkollë ka përcaktuar një koordinator të kurrikulës, i cili ju ofron kolegëve të vet mbështetje në dizajnimin dhe përpilimin e planeve javore e dymujore.

Për vitin 2017 plani i veprimit parasheh hartimin dhe rishikimin e të gjitha trajnimeve për drejtor, mësimdhënës dhe administrator shkollash, aktivitet ky i cili është realizuar gjatë këtij viti. Në këtë drejtim, IPK ka hartuar Udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, i cili është shpërndarë në shkolla përmes DKA-ve. Programi i trajnimit për drejtorë të shkollave, është rishikuar nga GIZ, por këtë fazë nuk dihet për nivelin e përfshirjes së pjesës së kurrikutit të rishikuar. Drejtoreshat e shkollave “Ismail Qemali”<sup>99</sup> dhe “Xhemajl Mustafa”<sup>100</sup> theksojnë se ato nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim për kurrikulën e re. Të dy drejtoreshat konsiderojnë se trajnimi i drejtorëve për kurrikulën e re është i domosdoshëm, sepse drejtori mund të jetë faktor shumë i rëndësishëm në zbatimin e kurrikulës së re.

Informimi i prindërve rreth kurrikulës së re është konsideruar i rëndësishëm në planin e veprimit të PSAK. Nga të dhënat e mbledhura kuptohet se janë organizuar 7 takime rajonale me drejtorë të shkollave, DKA dhe përfaqësues tjerë të arsimit, lidhur me informimin për kurrikulën e re, mirëpo nuk dihet nëse prindërit kanë qenë të përfshirë.

Për vitin 2017 plani i veprimit parasheh monitorimin e zbatimit të kurrikulës së re, mirëpo kjo nuk është realizuar deri në shtator 2017 kur janë mbledhur të dhënat për këtë raport.

#### 4.5.2. Tekstet Mësimore

Për vitin 2017 plani i veprimit parasheh të hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët, mirëpo kjo nuk është realizuar. Nuk është përcaktuar procesi i hartimit të teksteve shkollore, nuk është shpallur konkursi për tekste të reja shkollore dhe as nuk janë pranuar dhe shqyrtuar propozimet nga shtëpitë botuese. Për më tepër, vazhdon të ketë dilema nëse tekstet shkollore do të hartohen nga botues vendorë, do të përkthehen nga gjuhë të huaja apo do të merren nga Shqipëria.

Udhëheqësit në shkollat e vizituara “Ismail Qemali” dhe “Xhemajl Mustafa” janë shprehur të indinjuar në lidhje me cilësinë e teksteve aktuale shkollore në të gjitha nivelet. Sipas drejtoreshës së shkollës “Ismail Qemali”<sup>101</sup>, tekstet shkollore dhe fletoret e punës në shumë lëndë janë nga botues të ndryshëm dhe të pa-harmonizuara në mes vete. Kjo dërgon tek një vështirësi shtesë tek mësimdhënësit dhe një huti tek nxënësit. Ngjashëm, drejtoresha e shkollës “Xhemajl Mustafa”<sup>102</sup> thekson se shumica e teksteve nuk i përbushin kërkesat e Kurrikulës së re, dhe më keq qëndron puna me gjuhën angleze

94 Intervistë me Ismet Gashin, drejtor i SHFMU “Mihal Grameno, Fushë Kosovë, 18.0.2017.

95 Intervistë me Myrvete Krasniqin, mësimdhënëse në SHFMU “Selman Riza” Fushë Kosovë, 18.0.2017.

96 Intervistë me Shkurta Krasniqin, zëvendës-drejtoreshë në SHFMU “Zenel Hajdini” Prishtinë, 19.10.2017.

97 Intervistë me Mimoza Kryeziun, koordinatorë e cilësisë në SHFMU “Mihal Grameno” Fushë Kosovë, 18.10.2017.

98 Intervistë me Esad Simnicën, koordinator i kurrikulës dhe arsimtar i TIK në SHFMU “Selman Riza” në Fushë Kosovë, 18.10.2017.

99 Intervistë me Hatmane Demiri, drejtoreshë në shkollën “Ismail Qemali, Prishtinë, 06.10.2017.

100 Intervistë me Shpresa Shalën, drejtoreshë e shkollës “Xhemajl Mustafa” Prishtinë, 06.10.2017.

101 Intervistë me Hatmane Demiri, drejtoreshë në shkollën “Ismail Qemali”, Prishtinë, 06.10.2017.

102 Intervistë me Shpresa Shalën, drejtoreshë e shkollës “Xhemajl Mustafa” Prishtinë, 06.10.2017.

ku nuk ka fare tekste për klasat I,II, ndërkohë që tekstet e klasës së III, IV nuk janë më adekuate. Sipas znj. Shala tekstet shkollore në përgjithësi janë të shkruara keq, dhe gjithmonë ka pasur ankesa rreth teksteve.

Një analizë e teksteve shkollore aktuale<sup>103</sup> ka treguar se ato kanë defekte serioze në aspektin e saktësisë shkencore të fakteve, ngarkesës, nxitjes së të menduarit kritik, në aspektet didaktike-metodike dhe gjinore, si dhe në aspektin përmbajtësor. Edhe pse prej vitit 2013 janë bërë përpjekje për evitimin e këtyre defekteve, ato nuk kanë dhënë ndonjë rezultat të prekshëm, pasi edhe vitin 2017 ka pasur raportime të defekteve serioze në tekstet mësimore<sup>104105106</sup>.

Plani i veprimit për vitin 2017, gjithashtu, parasheh furnizimin e nxënësve me tekste shkollore falas, dhe kjo është realizuar pjesërisht. Tekstet falas janë ndarë vetëm për nivelin e shkollës fillore, ndërsa për nivelet tjera jo, si rezultat i mungesës së buxhetit. Gjithashtu nuk është realizuar as trajnimi i parashikuar i 2000 mësimdhënësve për shfrytëzimin e materialeve elektronike.

#### 4.5.3. Teknologjia arsimore

Pajisja e shkollave me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit është shumë e nevojshme për të siguruar zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re. Sipas planit të veprimit, në vitin 2017 parashihet të fillojë instalimi i infrastrukturës telekomunikuese në të gjitha institucionet edukative-arsimore, mirëpo në këtë fazë të grumbullimit të të dhënave nuk kemi marrë informatë në lidhje me këtë çështje. Gjatë vizitës në DKA<sup>107</sup> të komunës së Fushë Kosovës kuptohet se instalimi i infrastrukturës telekomunikuese në institucionet edukative-arsimore të kësaj komune është në proces. Të gjitha shkollat kanë kabinetin e TIK-ut. Gjatë kësaj periudhe gjimnazi i përgjithshëm “Hivzi Sylejmani” dhe shkolla e mesme ekonomike posedojnë 60 kompjuterë dhe 20 laptopë, dhe gjatë këtij viti DKA synon të furnizojë këto shkolla me 50 laptopë shtesë për përdorim të nxënësve. Edhe pse plani i veprimit parasheh që në 2017 të fillojë sigurimi i qasjes në internet për të gjitha institucionet edukative-arsimore, në shtator 2017 kuptohet se shumica e shkollave, por jo të gjitha, kanë qasje në internet. Kjo qasje është kryesisht për administratën e shkollës, dhe në disa shkolla edhe për kabinetin e informatikës, por jo për shfrytëzim më të gjerë në procesin mësimor. Gjithashtu është paraparë edhe furnizimi i 1,000 klasave me TV smart, mirëpo, sipas të dhënave të grumbulluara deri në shtator 2017, kjo nuk është realizuar. Në fakt vetëm shkolla Model në Prishtinë është furnizuar me një smart TV. Mirëpo gjatë intervistës në DKA<sup>108</sup> të komunës së Fushë Kosovës kuptohet se gjatë vitit 2017 SHFMU “Mihal Grameno” është furnizuar me 10 TV smart. Mungojnë informata të sakta për furnizimin e shkollave me kompjuterë, por dihet se ka pasur ca investime në këtë drejtim. Në vitin 2017 gjithashtu ishte paraparë inkurajimi i nxënësve dhe mësimdhënësve që t’i sjellin pajisjet personale të TIK-ut në shkollë dhe të bëhet lidhja e marrëveshjeve në mes të MASHT dhe kompanive të interesuara për ofrimin e kushteve të volitshme të pagesës së laptopëve, mirëpo nuk ka pasur asnjë progres në këtë drejtim.

103 Jusuf Thaçi: Problemet dhe të metat e teksteve shkollore, Prishtinë, janar 2013. [http://jetanekosove.com/repository/docs/Tekstet\\_ANALIZA\\_shqip\\_339320.pdf](http://jetanekosove.com/repository/docs/Tekstet_ANALIZA_shqip_339320.pdf)

104 <http://zeri.info/aktuale/170781/librat-plot-me-gabime-permbajtjesore-dhe-teknike/>

105 <http://www.koha.net/arberi/58992/prinderit-ankohen-se-ne-tekstet-shkollore-mohohen-te-drejtat-e-njeriut/>

106 <http://zeri.info/aktuale/173179/edhe-nje-skandal-me-tekstet-shkollore-kosova-ende-se-ka-shpallur-pavaresine/>

107 Intervistë me Islam Shabanin, drejtor i Arsimit në Fushë Kosovë, 16.10.2017.

108 Intervistë me Islam Shabanin, drejtor i Arsimit në Fushë Kosovë, 16.10.2017.

# ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL DHE ARSIMI PËR TË RRITUR





## 4.6. Objektivi 6: AAP dhe ARr

**Harmonizimi i arsimit dhe aftësisht profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.**

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Rreth 47% të nxënësve të arsimit të mesëm profesional vijojnë mësimet në drejtimet ekonomike-juridike dhe ato shëndetësore, me mundësi dukshëm më të vogla punësimi, ndërkohë që numri i nxënësve në drejtime me perspektivë më të mirë punësimi vazhdon të jetë nën nivelin e dëshiruar. Nuk ka lëvizje të duhura nga MASHT dhe DKA-të për ndryshimin e kësaj gjendjeje.

Pjesëmarrja e vajzave në arsimin e mesëm profesional nuk është në nivelin e dëshiruar, ku vërehet një përfaqësim i theksuar në të gjitha drejtimet që çojnë në, të ashtuquajtura, kualifikime “të rezervuara për meshkuj”.

Materialet mësimore adekuate ekzistojnë për 24 nga 135 profile të arsimit profesional, ndërsa në profilet tjera është i pranishëm një lloj “improvizimi” me shfrytëzimin e materialeve të përgatitura nga mësimdhënësit që nuk kanë kaluar nëpër ndonjë proces verifikimi. Ka ngecje në adresimin e këtij problemi.

Gjatë vitit 2016 dhe 2017 janë nënshkruar numër i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë për dërgimin e nxënësve në praktikë profesionale, mirëpo nuk ka ndonjë evidencë të saktë të këtyre marrëveshjeve e as raportim të saktë për shkallën e zbatimit të tyre në praktikë. Informatat nga terreni flasin për probleme serioze në realizimin e praktikës profesionale dhe për mbështetjen e këtij aspekti të zhvillimit të nxënësve në nisma që burojnë drejtpërdrejtë nga shkolla.

Me pak përjashtime, këshillimi dhe orientimi në karrierë vazhdon të mos jetë i pranishëm në shkollat profesionale të Kosovës. Megjithatë, janë duke u bërë përgatitjet për ofrimin e një kualifikimi të nivelit 5 për këshilltarët e karrierës.

SMIA ka filluar të mbledhë të dhëna për arsimin e të rriturve në Kosovë. Kështu, gjatë vitit shkollor 2016/17 në arsimin e mesëm profesional kanë qenë të përfshirë 1,794 të rritur, prej të cilëve 617 femra. Për fat të keq, nuk ka të dhëna për përfshirjen e të rriturve në forma të ndryshme të arsimit joformal.

Përkundër progresit në ofrimin e programeve për të rritur, arsimit i të rriturve mbetet sektori më i pazhvilluar i sistemit të arsimit, pasi ende nuk janë krijuar parakushtet e domosdoshme për menaxhimin e tij.

### 4.6.1. Trendet e regjistrimit dhe programeve mësimore

Sipas të dhënave statistikore të MASHT, 52.5% e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë vijojnë mësimin në njërin nga 14 lëmitë dhe 135 profilet e shkollave të mesme profesionale. Nga tabelat Tabela 6 dhe Tabela 7 vërehet se lëmitë më të preferuara për nxënësit janë drejtimi ekonomik-juridik me 14,1470 nxënës (47.6% vajza) dhe drejtimi i shëndetësisë dhe i mbrojtjes sociale me 7,152 nxënës (67.4% vajza). Në këto dy lëmi mësimet i vijojnë rreth 47% të nxënësve të regjistruar të arsimit profesional dhe 63.6% e të gjitha vajzave të regjistruara në shkolla profesionale.

Lëmi tjera të kërkuara janë ajo të makinerisë dhe përpunimit të metaleve me 5,099 nxënës (4.9% vajza), si dhe drejtimi i elektroteknikës me 7,761 nxënës (24.9% vajza). Në këto dy lëmi mësimet i vijojnë rreth 28% e të gjithë nxënësve të regjistruar në arsimin profesional, por vetëm 11.9% e vajzave të regjistruara në këtë nivel arsimit.



**Tabela 6.** Numri i nxënësve në arsimin e mesëm profesional në vitin shkollor 2016/17 sipas lëmive

Lëmi	Klasa 10		Klasa 11		Klasa 12		Gjithsej	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	GJ	F
Lëmi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit	27	3	16	4	9	0	52	7
Lëmi i xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë	118	52	106	42	119	31	343	125
Lëmi i makinerisë dhe përpunim i metaleve	2,261	89	1,737	117	1,101	46	5,099	252
Lëmi i elektroteknikes	3,059	693	2,608	688	2,094	555	7,761	1,936
Lëmi i gjeodezisë dhe ndërtimtarisë	966	339	727	204	576	181	2,269	724
Lëmi i trafikut	656	120	573	115	375	47	1,604	282
Lëmi i tekstilit dhe lëkurëtarisë	227	198	211	187	169	135	607	520
Lëmi i kimisë, i jometaleve dhe e grafikës	486	256	508	284	449	234	1,443	774
Lëmi i tregtisë, i hotelerisë dhe i turizmit	452	84	353	81	299	82	1,104	247
Lëmi ekonomik - juridik	5,603	2,577	4,723	2,359	4,144	1,953	14,470	6,889
Lëmi i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	2,635	1,778	2,387	1,595	2,130	1,449	7,152	4,822
Lëmi i kulturës, i artit dhe i informimit publik	361	247	300	204	235	143	896	594
Lëmi i bujqësisë dhe blegtorisë	726	240	674	255	382	132	1,782	627
Lëmi i teknologjisë ushqimore	644	242	472	222	377	158	1,493	622
	<b>18,221</b>	<b>6,918</b>	<b>15,395</b>	<b>6,357</b>	<b>12,459</b>	<b>5,146</b>	<b>46,075</b>	<b>18,421</b>

Burimi: Divizioni i AAP, MASHT

**Tabela 7.** Përqindja e nxënësve në arsimin e mesëm profesional në vitin shkollor 2016/17 sipas lëmive

Lëmi	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Gjithsej
Lëmi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit	0.15%	0.10%	0.07%	0.11%
Lëmi i xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë	0.65%	0.69%	0.96%	0.74%
Lëmi i makinerisë dhe përpunim i metaleve	12.41%	11.28%	8.84%	11.07%
Lëmi i elektroteknikes	16.79%	16.94%	16.81%	16.84%
Lëmi i gjeodezisë dhe ndërtimtarisë	5.30%	4.72%	4.62%	4.92%
Lëmi i trafikut	3.60%	3.72%	3.01%	3.48%
Lëmi i tekstilit dhe lëkurëtarisë	1.25%	1.37%	1.36%	1.32%
Lëmi i kimisë, i jometaleve dhe e grafikës	2.67%	3.30%	3.60%	3.13%
Lëmi i tregtisë, i hotelerisë dhe i turizmit	2.48%	2.29%	2.40%	2.40%
Lëmi ekonomik - juridik	30.75%	30.68%	33.26%	31.41%
Lëmi i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	14.46%	15.51%	17.10%	15.52%
Lëmi i kulturës, i artit dhe i informimit publik	1.98%	1.95%	1.89%	1.94%
Lëmi i bujqësisë dhe blegtorisë	3.98%	4.38%	3.07%	3.87%
Lëmi i teknologjisë ushqimore	3.53%	3.07%	3.03%	3.24%

Burimi: Divizioni i AAP, MASHT

Tabela 8 jep një pasqyrë të gjendjes së treguesve gjinorë në arsimin profesional. Nga tabela shihet se indeksi i paritetit gjinor në vitin shkollor 2016/17 është në një rritje të lehtë në raport me gjendjen fillestare dhe duke konvergjuar kah caku, ndërkaq përfaqësimi i vajzave në drejtimet teknike mbetet një sfidë në adresimin e së cilës duhet të punohet gjatë viteve në vijim.

**Tabela 8.** Treguesit gjinorë të arsimit profesional

Treguesi	Gjendja fillestare 2014/15	2016/17	Caku 2021
Indeksi i paritetit gjinor në arsimin profesional	0.63	0.67	0.7
Indeksi i paritetit gjinor në drejtime teknike	0.25	0.24	0.4

Burimi: PSAK 2017-2021, Divizioni i AAP, MASHT

Përderisa mungesa e interesimit për regjistrim rrezikon mbylljen e disa profileve për të cilat ekziston nevoja në tregun e punës, vërehet një hezitim për t'i rishikuar kuotat e regjistrimit në profile të mbipopulluara, siç janë ato nga lëmi ekonomik-juridik dhe lëmi i shëndetësisë e mirëqenies sociale. Arsyeja kryesore e një hezitimi të tillë është shmangia e rrezikut nga krijimi i tepicës teknologjike dhe mungesa e gatishmërisë për t'u përballur me ri-organizimin e rrjetit të shkollave profesionale. Me përjashtim të disa drejtimeve, shkollat e mesme profesionale vazhdojnë të shihen si mundësi e dytë për nxënësit, të cilët nuk kanë treguar sukses për t'u regjistruar në gjimnaze.

Gjatë vitit 2017, AKK ka përfunduar procesin e verifikimit të standardeve të profesionit dhe janë miratuar në Këshillin Drejtues të saj 15 standarde të profesionit si standarde në nivel kombëtar. Disa prej standardeve të miratuara janë: polic/e (niveli 5 sipas KKK); inspektor i policisë/detektiv (niveli 5); ndihmës-kuzhinier (niveli 3), banakier (niveli 3), këshilltar/e i/e karrierës (niveli 5), etj.

#### 4.6.2. Kurrikulat dhe materialet mësimore

Harmonizimi i Kurrikulave të AAP dhe arsimit për të rriturit me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve është një masë me rëndësi e PSAK. Korniza e kurrikulës për arsim parauniversitar është ombrellë e gjithë arsimit parauniversitar në Kosovë, në kuptim të përcaktimit të kompetencave që duhet arritur. Harmonizimi në mes të Kornizës Kurrikulare dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve është bërë në kohën kur është hartuar, prandaj nuk ka ndonjë konflikt në mes të këtyre dy dokumenteve. Këtë konflikt mund ta shkaktojë shumë lehtë Kurrikula Bërthame, në rast se nuk i reflekton kërkesat e Kornizës Kurrikulare.

Sipas z. Ajet Brajshorit, drejtor në shkollën e mesme të lartë profesionale “28 Nëntori” në Prishtinë, ekziston një draft dokument i harmonizimit të Kurrikulave të AAP-së me Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar. Puna në këtë dokument i cili është ende në proces të hartimit ka filluar prej vitit 2016 nga grupi punues, i përbërë nga përfaqësues të MASHT dhe përfaqësues të shkollave profesionale. Në anën tjetër, zëvendës drejtori i shkollës profesionale ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina” në Prishtinë, z. Osman Zeqiri tregon se nuk është në dijeni që ekziston një grup i tillë punues për harmonizimin e kurrikulave.<sup>109</sup>

Njëra nga problemet vazhdimisht të ngritura në sistemin e performancës së AAP, janë edhe materialet mësimore të cilat nuk janë të cilësisë së duhur e që mungojnë në pothuajse shumicën e profileve. Deri tani, me materialet mësimore janë të mbuluara 24 profile, ndërsa në profilet tjera mungojnë, apo janë të zhvilluara nga mësimdhënësit por nuk janë të strukturuar. Ka raste kur mësimdhënësit marrin materialet nga burime të ndryshme dhe i adoptojnë ato për nevojat e tyre. Në qendrat e kompetencës, situata qëndron më mirë, pasi profilet janë zhvilluar me përkrahjen e donatorëve, dhe, në këtë rast, janë zhvilluar edhe materialet mësimore. Megjithatë, edhe në këto raste ato materialet nuk janë rishikuar dhe përditësuar.

Nga të dhënat e grumbulluara deri në tetor 2017 kuptohet se ka ngecje në realizimin e disa proceseve të AAP-së: grupet punuese për përzgjedhjen e materialeve ekzistuese për secilin sektor ekonomik ende nuk janë formuar, nuk është përgatitur asnjë udhëzues për hartimin e teksteve për lëndë profesionale, nuk janë themeluar grupet e autorëve për tekste të materialeve të lëndëve profesionale, si dhe nuk është realizuar as aktiviteti për themelimin e grupeve punuese me autorë të materialeve të përzgjedhura nga secili sektor ekonomik.

#### 4.6.3. Puna praktike

Mësimi praktik në shkollë dhe praktika profesionale jashtë shkollës mbetet njëra nga temat e diskutuara gjatë, por që nuk ka rezultate të kënaqshme. Mund të konkludohet se ka një përmirësim të pjesëmarrjes së nxënësve në praktikë profesionale dhe se ka një përmirësim të raporteve shkollë-ndërmarrje, mirëpo ende ka shumë probleme në këtë drejtim. Si rezultat i mos-realizimit të praktikës profesionale, nxënësit nuk arrijnë të përgatitën për tregun e punës dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre praktike për punë. Gjatë vitit 2017 ka qenë e paraparë të mbahen punëtori me qëllim të ndërtimit të platformës së bashkëpunimit shkollë-kompani, por ato nuk janë realizuar. Mirëpo, janë mbajtur shumë trajnime informuese për shkollat e AAP lidhur me instrumentet e dala nga platforma të cilën e zhvillon projekti i LuxDev që mbështet AAP-në.

Disa aktivitete që janë paraparë në planin e veprimit e që mund të ndikojnë në një funksionim më të mirë të shkollave profesionale nuk janë realizuar gjatë vitit 2017. Për shembull, nuk bëhet transporti i nxënësve dhe instruktorëve që udhëtojnë për të kryer punën praktike nëpër kompani, me përjashtim të disa komunave të cilat iu kanë mbuluar këto shpenzime. Deri në periudhën e raportimit nuk është përfunduar rregullorja për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve gjatë punës praktike. Aktivitete tjera të cilat nuk janë realizuar janë: pagesa e sigurimit për nxënësit, përgatitja e manualit të trajnimit apo organizimi i trajnimit të personelit të zyrave për bashkëpunim ekonomik, themelimi i tri punëtorive të shkollave të profileve të ndryshme profesionale, hartimi i dokumentit me kriteret për themelimin e partneriteteve publike-private në fushën e arsimit.

<sup>109</sup> Intervistat me Ajet Brajshorin, drejtor në shkollën teknike “28 Nëntori” dhe me Osman Zeqirin, zëvendës drejtor në shkollën ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtinë” janë mbajtur me datë 12 tetor 2017.

Gjatë vitit 2016 dhe 2017 janë nënshkruar numër i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë për dërgimin e nxënësve në praktikë profesionale, mirëpo nuk ka ndonjë evidencë të saktë të këtyre marrëveshjeve e as raportim të saktë për shkallën e zbatimit të tyre në praktikë.

Gjendjen komplekse të praktikës profesionale e vërtetojnë edhe vizitat tona në terren. Drejtorët pajtohen se kjo paraqet një sfidë të madhe. Ata tregojnë se praktika profesionale jashtë shkollës realizohet duke u bazuar vetëm në iniciativat e shkollës, duke shfrytëzuar edhe lidhjet private, dhe se gjithmonë mungon përkrahja institucionale. Kompanitë nuk pranojnë numër të madh të nxënësve, kështu që shkollat janë të detyruara të dërgojnë nxënësit e ndarë në grupe prej 6-7 persona.

#### 4.6.4. Këshillimi dhe orientimi në karrierë

Të dhënat tregojnë se këshillimi dhe orientimi në karrierë nuk është funksional në sistemin e AAP-së. Në disa komuna ekzistojnë qendrat e këshillimit dhe orientimit në karrierë në nivel komunal, si rasti në Prishtinë, apo zyrat e këshillimit dhe orientimit në karrierë janë të vendosura brenda shkollave, si rasti i shkollës profesionale në Vushtrri. Mirëpo, kjo është arritur, kryesisht, nga iniciativat e projekteve të ndryshme, e jo si rezultat i një plani gjithëpërfshirës. Disa modalitete se si mund të funksionojnë këto qendra janë dhënë nga projekte të ndryshme si projektet EYE, LuxDev etj. Në këtë aspekt shumë më keq qëndron arsimit për të rritur, ku mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë, nuk ndihmon të rriturit me rastin e marrjes së vendimit për vazhdimin e shkollimit të ndërprerë ose rikualifikimit në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Problemet e këshillimit dhe orientimit në karrierë janë evidente edhe tek punëkërkuarit, ku në shumicën e rasteve, këshilltarët në zyrat e punësimit nuk kanë informacion rreth mundësive të shkollimit, njohjes së mësimin paraprak apo certifikimit të njohurive të kandidatëve punëkërkuar.

Të dy shkollat profesionale në Prishtinë të vizituara nga ekipi hulumtues, nuk kanë qendra të karrierës brenda shkollës dhe nuk kanë këshilltarë të karrierës. Drejtorët e shkollave profesionale e shohin shumë të nevojshëm funksionalizimin e qendrave të tilla. Ata theksojnë se Qendra për Karrierë në Prishtinë, në fillim, kishte aktivitete të shumta, si ekspozita me punime të nxënësve, trajnime për mësimdhënësit, por ai tani mohon të ketë aktivitete të tilla.

Edhe pse figuron si aktivitet në planin e veprimit të PSAK 2017, nuk është mbajtur ndonjë trajnim i mësimdhënësve për zhvillimin e kurrikulave dhe orientim në karrierë. Megjithatë, pritet që, me përkrahjen e LuxDev, në qendrat e kompetencës në Ferizaj dhe Prizren të ofrohen kualifikime ndërkombëtare të nivelit 4-5, të njohura si BTEC<sup>110</sup>, në mesin e të cilave edhe kualifikimi për këshilltar karriere. Në anën tjetër, ashtu siç ishte e paraparë me planin e veprimit të PSAK 2017, gjatë vitit 2017, është zhvilluar dhe verifikuar Standardi i profesionit për Këshilltar të Karrierës, si dhe është aprovuar nga AKK.

110 <http://qualifications.pearson.com/en/about-us/qualification-brands/btec.html>

#### 4.6.5. Arsimit i të rriturve

Nga të dhënat e mbledhura kuptohet se ekziston një rregullore për menaxhimin e të hyrave vetanake të institucioneve për aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve, mirëpo në aspektin praktik, institucionet e tilla kanë pasur vështirësi në menaxhimin e të hyrave vetanake. Kjo ankesë është shprehur nga qendrat e kompetencës, të cilat, gjatë periudhës së kanë qenë nën menaxhimin e komunave, kanë arritur të menaxhojnë me të hyrat e tyre vetanake, ndërsa me kalimin nën AAAPARr, mjetet e tyre kanë kaluar në buxhetin e Ministrisë së Financave, dhe, për pasojë, nuk kanë mundur të disponojnë me to. Megjithatë, nga viti 2018 qendrat e kompetencave do të kenë mundësi të menaxhojnë me të hyrat e tyre vetanake.

Mirëpo edhe pse e paraparë në planin e veprimit të PSAK 2017, nuk është bërë rishikimi i programeve të institucioneve të AAP-së që ofrojnë arsimimin për të rritur. Nga të dhënat e grumbulluara deri në tetor 2017 kuptohet se ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimimit për të rriturit. SMIA ka filluar të mbledhë dhe të raportojë të dhëna edhe për arsimimin e të rriturve që bënë të mundur përcjelljen e gjendjes në këtë sektor. Kështu, gjatë vitit shkollor 2016/17 në arsimin e mesëm profesional kanë qenë të përfshirë 1,794 të rritur, prej të cilëve 617 femra<sup>111</sup>. Për fat të keq, nuk ka të dhëna për përfshirjen e të rriturve në forma të ndryshme të arsimit joformal.

Në kuadër të rritjes së ofertës së shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve të dhënat e mbledhura tregojnë se ende nuk është bërë studimi i paraparë nga plani i veprimit të PSAK 2017, lidhur me nevojat e ofrimit të kualifikimeve në nivelin 5 dhe as nuk është bërë analizë e legjislacionit në fuqi dhe nevojave për kualifikimin e nivelit 5. Në anën tjetër, ashtu sikur është paraparë në plan të veprimit të PSAK 2017, janë zhvilluar disa programe të nivelit të 5, mirëpo jo nga shkollat publike profesionale, por nga ofrues tjerë publik joformal dhe ofrues privat të AAP-së. Dy programe janë zhvilluar në bashkëpunim me Pearson nga një projekt i financuar nga LuxDev ku në QK Ferizaj ka filluar programi i nivelit 5 për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta dhe në QK Prizren, ku, nga tetori i 2017, fillon programi për këshilltar karriere. Programe tjera të nivelit 5 edhe në lëmin e kontabilitetit, TI-së, etj.

111 Statistikat e Arsimit 2016/17, MASHT, qershor 2017.

# ARSIMI I LARTË



## 4.7. Objektivi 7: Arsimi i lartë

**Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.**

### PËRMBLEDHJE E MONITORIMIT:

Përkundër zvogëlimit të numrit të institucioneve të arsimit të lartë nga 36 në 31, Kosova vazhdon të mbetet vend me numrin më të madh të institucioneve për 1 mil. banorë krahasuar me çdo vend tjetër të rajonit.

Projektiligji i arsimit të lartë i dorëzuar në Kuvend që në tetorin e vitit 2015 akoma nuk është aprovuar. Nuk ka pasur lëvizje drejt zbatimit të normave ligjore për financim të institucioneve të arsimit të lartë në bazë të performancës.

Numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë ka vazhduar të rritet, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e lartë është 84.23% që e radhitë Kosovën në vendin e tetë në botë, ndërsa i tejkalon të gjitha vendet evropiane përveç Greqisë, Spanjës, Bellorusisë dhe Finlandës.

Shkalla e diplomimit me kohë për gjeneratën 2013/14 është 43.68% që është akoma larg nga caku i përcaktuar prej 60%.

Numri i stafit akademik të kualifikuar në institucionet e arsimit të lartë është i pamjaftueshëm – derisa përpjestimi “mësimdhënës-student” në nivel vendi është 1:41, në sektorin publik mbetet akoma më i pavolitshëm – 1:60.

Megjithëse ka përmirësime në zbatimin e kriterëve për zgjedhjen e stafit akademik, nuk ka pasur veprime konkrete për adresimin e shkeljeve flagrante të integritetit akademik nga ana e ndonjë institucioni të arsimit të lartë në Kosovë.

Si rezultat i përpjekjeve të AKA për zbatimin e kriterëve të akreditimit, numri i programeve të akredituara është zvogëluar për më shumë se një të katërtën nga viti 2015. AKA ka insistuar që secili program studimor të ketë tre bartës me thirrje doktor i shkencave, duke mos lejuar që bartësit e njëjtë të jenë në më shumë se një program. Përkundër suksesit fillestar, Bordi i AKA është shkarkuar në shtatorin e vitit 2017 pas kërkesës së kryeministrit të Kosovës, me arsyetim se mban përgjegjësi për gjendjen në arsimin e lartë.

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë vazhdojnë të ngecin prapa institucioneve të rajonit në rankimet ndërkombëtare. Edicioni i Webometrics i dhjetorit të vitit 2017 e klasifikon Universitetin e Prishtinës në vendin e 3,960-të, ndërsa të gjitha institucionet tjera të arsimit të lartë në Kosovë rangohen më poshtë. UP mbetet larg universiteteve të tjera publike nga kryeqytetet e vendeve të Ballkanit, me përjashtim të universiteteve nga Tirana.

Vazhdon të ketë shpërputhje në mes të ofertës së programeve të arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës, si në aspektin përmbajtësor dhe cilësor, ashtu edhe në aspektin e orientimit të studentëve në ato fusha të studimit ku ka më shumë nevojë për kadro.

### 4.7.1. Struktura institucionale e arsimit të lartë

Në vitin 2017, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përbëhet nga 30 institucione të akredituara të arsimit të lartë, prej të cilave 9 publike dhe 21 private<sup>112</sup>. Kësaj liste duhet shtuar edhe Universitetin e Mitrovicës së Veriut, i cili ofron programe në gjuhën serbe, por vazhdon të zhvillojë veprimtarinë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë. Numri prej 31 institucioneve të arsimit të lartë paraqet zvogëlim në raport me vitin 2015, kur, në Kosovë, ishin 36 institucione të arsimit të lartë. Ky zvogëlim ka ardhur si rezultat i pushimit të veprimtarisë të një numri të institucioneve, qoftë për shkak të refuzimit të akreditimit apo për shkaqe të tjera.

Megjithëkëtë, Kosova vazhdon të mbetet vend me numër të madh të institucioneve të arsimit të lartë për 1 mil. banorë. Grafiku 1 jep krahasimin me disa shtete evropiane. Në kushtet e dhëna, kjo flet për mungesë kontrolli nga ana e shtetit dhe angazhim të pamjaftueshëm për sigurimin e cilësisë që do të shtjellohet në seksionin 4.7.3.

**Grafiku 1.** Numri i institucioneve të arsimit të lartë për 1 milionë banorë

Kosova		17
Shqipëria		13
Turqia		2
Slovenia		17
Mali i Zi		5
Kroacia		12
Serbia		5
Moldova		7
Maqedonia		10
Bosnja e Hercegovina		16
Bashkimi Evropian		7

Burimi: Të dhënat nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës, Eurostat dhe [www.webometrics.info](http://www.webometrics.info)

Projektligji i ri për arsimin e lartë është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në tetorin e vitit 2015, por nuk ka mundur të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës për shkak të mospajtit të deputetëve të komunitetit serb dhe mungesës së mbështetjes në Komisionin Parlamentar për Arsim. Qeveria e Kosovës e dalë nga zgjedhjet e qershorit të vitit 2017, është duke e bërë rishikimin e këtij projektligji dhe pritet që ai përsëri t'i dërgohet Kuvendit për aprovim.

Ligji për profesionet e rregulluara i aprovuar në fund të vitit 2016 ende nuk ka filluar të zbatohet, edhe pse 3 muaj pas hyrjes së tij në fuqi është dashur të nxirren aktet nënligjore për zbatimin e ligjit dhe të funksionalizohen organet e reja që parashihen me këtë ligj.

Në periudhën 2015-2017 është zhvilluar Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL), i cili bën të mundur gjenerimin e të dhënave të nevojshme për analizën e gjendjes në këtë sektor dhe vendimmarrje të informuar. Ky hap paraqet përmirësim në raport me gjendjen paraprake, gjë që shihet edhe nga dy përmbledhjet e fundit të statistikave të arsimit për vitet 2015/16 dhe 2016/17<sup>113</sup>, të cilat sjellin të dhëna të përdorshme për arsimin e lartë, edhe pse ka vend për përmirësim të mëtejshëm. Megjithatë, ende nuk ka filluar publikimi i të dhënave të plota në përputhje me konceptin e SMIAL, ndërkaq ekipi ynë monitorues nuk ka marrë asnjë përgjigje në kërkesën për qasje në të dhënat e SMIAL.

Ligji për Arsimin e Lartë parasheh ndërtimin e mekanizmave efektivë për financim transparent që nxitë llogaridhënien. Ky financim bëhet mbi bazën e planeve 3-vjeçare që negocohen në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe MASHT. Për fat të keq, nuk ka pasur lëvizje drejt zbatimit të normave të këtij ligji, por ka vazhduar financimi i arsimit të lartë në bazë të shumave buxhetore fikse dhe kërkesave të institucioneve të arsimit të lartë.

#### 4.7.2. Studentët në arsimin e lartë

Në Kosovë vazhdon trendi i rritjes së interesimit për studime në arsimin e lartë. Në vitin akademik 2016/17, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë vijonin studimet 123,243 persona, prej të cilave 52.1% femra (Tabela 9). Nëse këtij numri i shtohen edhe 10,000 studentë të Universitetit të Mitrovicës së Veriut<sup>114</sup>, atëherë mund të llogarisim se **në Kosovë ka të paktën 133,243 studentë.**

113 Statistikat e Arsimit 2015/16 dhe Statistikat e Arsimit 2016/17, ASK.  
114 [https://pr.ac.rs/univerzitet/univerzitet\\_danas/](https://pr.ac.rs/univerzitet/univerzitet_danas/)

**Tabela 9.** Studentët në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në vitin akademik 2016/17

Institucioni	Baçelor		Master		Gjithsej	
	Gj	F	Gj	F	G	F
Universiteti i Prishtinës	38,974	21,932	9,504	5,320	48,478	27,252
Universiteti i Prizrenit	6,796	4,056	663	293	7,459	4,349
Universiteti i Pejës	7,199	2,988	1,274	713	8,473	3,701
Universiteti i Mitrovicës	3,015	1,493	270	120	3,285	1,613
Universiteti i Gjilanit	3,517	2,267			3,517	2,267
Universiteti i Gjakovës	2,775	2,124			2,775	2,124
Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj	1,333	632	86	47	1,419	679
Fakulteti i Studimeve Islame	355	144	22	6	377	150
Akademia për siguri publike	179	53			179	53
Institucionet publike	64,143	35,689	11,819	6,499	75,962	42,188
Kolegjet private	41,988	19,509	5,293	2,558	47,281	22,067
Gjithsej	106,131	55,198	17,112	9,057	123,243	64,255


Burimi: Statistikat e Arsimit 2016/17, ASK, qershor 2017



Trendi i rritjes në pesë vitet e fundit vërehet qartë nga Grafiku 2. Këtu duhet marrë parasysh se Agjencia e Statistikave të Kosovës i ka raportuar për herë të parë të dhënat nga institucionet private të arsimit të lartë për vitin akademik 2015/16, prandaj rritja e numrit të studentëve në këtë sektor për afro 10,000 në raport me vitin paraprak mund të jetë “korrigjim” i gabimeve që kanë lindur nga mbledhja parciale e të dhënave deri në vitin akademik 2014/15.

Këto të dhëna, japin vlera të reja të treguesve të pjesëmarrjes në arsimin e lartë që janë prezantuar në tabelën Tabela 10. Treguesi i parë është modifikuar në përputhje me Kornizën e treguesve të arsimit të publikuar së voni nga MASHT<sup>115</sup> dhe paraqet regjistrimin e përgjithshëm të studentëve në arsimin e lartë, pavarësisht nga moshë, e shprehur si përqindje e popullsisë të moshës 18-22 vjeç<sup>116</sup>. Për shkak të ndryshimit kemi kalkuluar vlerën e treguesit për vitin 2014/15 (gjendja fillestare) si dhe vlerën e tij për vitin 2016/17. Ndërkaq, treguesi i dytë, numri i studentëve në 100,000 banorë, po ashtu, bën pjesë në kornizën e treguesve të arsimit<sup>117</sup> dhe është përdorur edhe më herët në formë të njëjtë.

**Grafiku 2.** Studentët në institucionet e arsimit të lartë në pesë vitet e fundit



Burimi: Vlerësimi i PSAK 2011-2015, Statistikat e arsimit 2015/16 dhe 2016/17

115 Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë, MASHT, tetor 2017.  
116 Në PSAK kjo grupmoshë ka qenë 20-24 vjeç në përputhje me treguesin e Eurostat.  
117 Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017-2021, ASK, dhjetor 2017.

Ndryshimi në dy treguesit e lartpërmendur, në raport me gjendjen në vitin akademik 2014/15 është mjaft i madh, për të paktën dy arsye. Arsyeja e parë është rritja e përkthuar më sipër e numrit të studentëve për rreth 10,000 persona nga viti akademik 2014/15 në vitin 2015/16. Ndërkaq, arsyeja e dytë qëndron tek ndryshimet në vlerësimin e popullsisë. Parashikimi i ri i popullsisë i publikuar nga ASK vlerëson se popullsia e përgjithshme e Kosovës dhe ajo e moshës 18-22 vjeç është më e vogël se që tregon vlerësimi i mëhershëm<sup>118</sup>.

Sidoqoftë, të dhënat e reja janë më të besueshme, prandaj mund të konstatohet se Kosova me pjesëmarrje prej 84.23% në arsimin e lartë është në mesin e vendeve me pjesëmarrje më të lartë në botë. Kjo shihet edhe nga Grafiku 3, ku janë prezantuar të dhënat e UNESCO për pjesëmarrje në arsimin e lartë të viteve 2013 ose 2014. Kosova zë vendin e tetë në botë për kah shkalla e regjistrimit në arsimin e lartë, ndërsa i tejkalon të gjitha vendet evropiane përveç Greqisë, Spanjës, Bjellorusisë dhe Finlandës.


Rezultate të ngjashme fitohen duke krahasuar numrin e studentëve në 100,000 banorë me vendet e tjera.

**Tabela 10.** Treguesit e pjesëmarrjes në arsimin e lartë

Treguesi	Gjendja fillestare 2014/15	Gjendja 2016/17	Komente
Shkalla bruto e regjistrimit (numri i studentëve si përqindje e popullsisë të moshës 18-22 vjeç)	68.10%	84.23%	Në vitin akademik 2016/17 janë 133,243 studentë. Ndërkaq, popullsia e Kosovës e moshës 18-22 në vitin 2017 vlerësohet në 158,102 banorë.
Numri i studentëve në 100,000 banorë	6,669	7,471	Në vitin akademik 2016/17 janë 133,243 studentë. Ndërkaq, popullsia e Kosovës në vitin 2017 vlerësohet në 1,783,531 banorë.
Indeksi i paritetit gjinor në arsimin e lartë	1.01	1.09	Nuk është llogaritur Universiteti i Mitrovicës së Veriut pasi të dhënat nuk janë të zërthyer sipas gjinisë.

118 Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2021, ASK, dhjetor 2013.

**Grafiku 3.** Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e lartë



Burimi: UN Data - [http://data.un.org/Data.aspx?d=UNESCO&f=series%3AGER\\_56](http://data.un.org/Data.aspx?d=UNESCO&f=series%3AGER_56)

Nga tabelat 9 dhe 10 vërehet se pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm. Femrat përbëjnë 55.5% të studentëve në sektorin publik dhe 46.7% të studentëve në sektorin privat. Shkaqet e një shpërputhjeje të tillë ia vlen të analizohen në të ardhmen.


Shkalla e diplomimit me kohë e studentëve kosovarë nuk është e kënaqshme. Në grafikun 4 është prezantuar një analizë e gjendjes së gjeneratave të regjistruara në vitin 2010/11 -2013/14, duke krahasuar numrin e të regjistruarve në ato vite me numrin e të diplomuarve tre vjet më vonë. Është e qartë se të gjitha studimet nuk janë trevjeçare, por numri i të diplomuarve pas kësaj periudhe merret si masë e efikasitetit në studime. Grafiku tregon se femrat i përgjigjen më mirë obligimeve të tyre sesa meshkujt dhe, po ashtu, se shkalla e diplomimit në sektorin privat është dukshëm më e lartë sesa në sektorin publik. Në përgjithësi, shkalla e diplomimit me kohë për gjeneratën 2013/14 është 43.68% që është në nivelin e gjendjes fillestare të përcaktuar me PSAK (43.29%)<sup>119</sup>. Të dhënat e OECD të vitit 2004 flasin për një shkallë të diplomimit me kohë prej 70% në vendet e OECD dhe 69% në vendet e BE<sup>120</sup>.

119 Shih Plani i Veprimit të PSAK 2017-2021, MASHT, shtator 2016, f.41.  
120 <http://www.oecd.org/edu/skills-beyond-school/39245059.xls>

#### 4.7.3. Personeli akademik

Siç shihet nga grafiku 5, institucionet publike të arsimit të lartë vazhdojnë të kenë numër të pamjaftueshëm të personelit akademik të rregullt. Përpjesëtimi “mësimdhënës-student” në institucionet publike është 1:60 ku në situatë mjaft të keqe janë universitetet në Prizren, Pejë, Gjilan dhe Gjakovë, ndërkohë që gjendja në Universitetin e Prishtinës mbetet në nivelin e disa viteve të fundit - 1:53. Ndërkaq, në situatë diç më të mirë ndodhet Universiteti i Mitrovicës.

**Grafiku 4.** Shkalla e diplomimit me kohë e gjeneratave të studentëve 2010/11-2013/14















Burimi: Vlerësimi i PSAK 2011-2015, Statistikat e arsimit 2015/16 dhe 2016/17



Numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit të lartë. Kështu, një hulumtim i realizuar nga “Perport” raporton për numër të madh të temave të diplomës që mbikëqyren nga disa profesorë të Universitetit të Prishtinës që mbajnë mësim në programet ku përpjesëtimi “mësimdhënës-student” është i pavolitshëm<sup>121</sup>. Sipas këtij hulumtimi, një profesoreshë që mban edhe post të lartë menaxhues në UP ka mentoruar 148 tema të diplomës për 2 vite e gjysmë ose mesatarisht 60 brenda një viti. Pa dyshim se situatat e tilla mund të çojnë mesazhe të gabueshme tek studentët, të cilët mund të kërkojnë “rrugë alternative” për përgatitjen e diplomave, pa përjashtuar plagjiaturën dhe mashtrimin. Rreziku tjetër që bartë numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar janë grupet e mëdha të studentëve, ku mësimdhënësi nuk arrin t’i kushtojë kujdesin e duhur nevojave individuale të studentëve, ndërkohë që procesi i vlerësimit të njohurive është sipërfaqësor.

**Grafiku 5.** Numri i studentëve për një mësimdhënës

Universiteti i Prishtinës		53
Universiteti i Prizrenit		141
Universiteti i Pejës		117
Universiteti i Mitrovicës		31
Universiteti i Gjilanit		91
Universiteti i Gjakovës		74
Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj		57
Fakulteti i Studimeve Islame		42
Akademia për Siguri Publike		20
Institucionet publike		<b>60</b>
Kolegjet private		27
Gjithsej		42

Burimi: Statistikat e arsimit 2016/17

121 Pazarit me tema të diplomës, Buletin Preport, 2017.

Çështja e zgjedhjes së stafit akademik vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes së opinionit publik. Gjatë vitit akademik 2016/17, ky proces është monitoruar në Universitetin e Prishtinës nga Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), sipas të cilës ka përmirësim në vlerësimin e kredencialeve akademike të kandidatëve nga ana e organeve të UP<sup>122</sup>. Sipas raportit të ORCA, “margjina e mospërputhjes mes gjetjeve të ORCA-s dhe të menaxhmentit të UP-së, e rrjedhimisht, vendimeve të Senatit është rreth 5%”. Me këtë rast duhet theksuar se ORCA, kryesisht, ka monitoruar plotësimin e kushtit rreth numrit minimal të publikimeve ndërkombëtare që kërkohen për zgjedhje në thirrje të caktuara akademike, duke i kushtuar kujdes besueshmërisë së revistave ku ato janë publikuar. Insistimi në plotësimin e këtij kushti dhe monitorimi i punës në UP nga ana e organizatave të shoqërisë civile, ka rezultuar me reagime publike nga disa mësimdhënës të UP, të cilët konsiderojnë se kjo qasje mund ta dëmtojë universitetin, në veçanti shkencat shoqërore dhe humane<sup>123124125</sup>.

Përkundër denoncimeve të shumta të akumuluar në disa vitet e fundit, nuk ka pasur veprime konkrete për adresimin e shkeljeve flagrante të integritetit akademik nga ana e ndonjë institucioni të arsimit të lartë në Kosovë. Në veçanti, veprimi ka munguar në Universitetin e Prishtinës ku vazhdojnë të punojnë, madje edhe të mbajnë poste udhëheqëse, profesorë që janë implikuar në raste flagrante të mashtrimit akademik.

Në vitet e fundit janë bërë hapa konkretë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UP, duke ri-aktivizuar Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie me ndihmën e Programit të Leadershipit Transformues të financuar nga USAID.

#### 4.7.4. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë

Cilësia e arsimit të lartë vazhdon të jetë temë e debatit publik në Kosovë dhe ekziston një konsensus i përgjithshëm se ajo është larg nga ajo që quhet e pranueshme. Në vitet 2016 dhe 2017, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka treguar një qëndrim më të rreptë gjatë procesit të akreditimit të institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë, gjë që ka rezultuar me zvogëlimin e numrit të programeve të akredituara në të gjitha nivelet, siç shihet nga tabela 11.

AKA është përqendruar në plotësimin e kushteve për personelin akademik të rregullt, duke kërkuar që për secilin program të studimeve të jenë 3 doktorë të shkencave dhe duke mos lejuar që personat e njëjtë të paraqiten si bartës në dy programe të ndryshme. Pavarësisht faktit se AKA nuk ka shqyrtuar nëse kualifikimet e stafit akademik janë adekuate për programe konkrete, një numër i konsiderueshëm i institucioneve të arsimit të lartë, nuk kanë arritur t’i sigurojnë tre doktorë të shkencave për secilin program. Këtu duhet theksuar se AKA i është kundërvënë me vendosmëri përpjekjeve për të regjistruar si bartës të programeve persona nga Maqedonia dhe Shqipëria, të cilët vazhdojnë të jetojnë dhe punojnë në institucionet e këtyre dy vendeve fqinje.

122 Analiza e procesit të zgjedhjes së stafit akademik nga konkursi 3/671 2016-17 në Universitetin e Prishtinës, ORCA, nëntor 2017.

123 Shemi Krasniqi, “Princat me pincetë”, Koha.net, 30 nëntor 2017. <http://www.koha.net/veshtrime/60573/princat-me-pincete/>

124 Arsim Canolli, “Universiteti dhe integriteti akademik”, Koha.net, 13 dhjetor 2017. <http://www.koha.net/veshtrime/63238/universiteti-dhe-integriteti-akademik/>

125 Muhamet Hamiti, “Apologji për vlerat e pamatshme të universitetit”, Klankosova.tv, 18 dhjetor 2017. <http://klankosova.tv/kolumne/apologji-per-vlerat-e-pamatshme-te-universitetit/>

**Tabela 11.** Programet e akredituara nga AKA


Viti akademik	Bachelor	Master	Doktoratë	Gjithsej
2010/11	196	113	1	310
2011/12	212	129	12	353
2012/13	240	154	25	419
2013/14	270	181	26	477
2014/15	262	180	26	468
2017/18	217	107	20	344

Burimi: Informatë nga AKA

Përkundër suksesit fillestar, Bordi i AKA është shkarkuar në shtatorin e vitit 2017 pas kërkesës së Kryeministrit të Kosovës, me arsyetim se mban përgjegjësi për gjendjen në arsimin e lartë. Ndërkaq, Bordi i ri i emëruar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë akoma nuk e ka kaluar procedurën e ratifikimit në Kuvend. E gjithë kjo ka bërë që Bordi i KAA të jetë jofunksional, duke rrezikuar funksionimin e AKA si faktor kyç për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Rankimi i vetëm ndërkombëtar që përfshin institucionet e arsimit të lartë në Kosovë është Webometrics që realizohet nga një institut kërkimor në Spanjë. Webometrics mat madhësinë dhe prezencën në web të institucioneve të arsimit të lartë dhe ka një korrelacion mjaft të mirë me rankimet tjera ndërkombëtare në rastin e institucioneve më prestigjioze të arsimit të lartë në botë. Edicioni i Webometrics i dhjetorit të vitit 2017 e klasifikon Universitetin e Prishtinës në vendin e 3,960-të, ndërkaq të gjitha institucionet tjera të arsimit të lartë në Kosovë rankohen më poshtë. Një krahasim i rankimit të Universitetit të Prishtinës me universitetet e kryeqyteteve tjera të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të universiteteve të Tiranës, tregon se pozicioni i tanishëm i arsimit të lartë në Kosovë lë shumë për të dëshiruar (Grafiku 6).

**Grafiku 6.** Rankimi Webometrics i universiteteve të rajonit, dhjetor 2017



Burimi: [www.webometrics.info](http://www.webometrics.info), Rankimi dhjetor 2017.

#### 4.7.5. Lidhja me tregun e punës

Studime të ndryshme tregojnë se probleme kyçe që pengojnë zhvillimin ekonomik në Kosovë janë ekonomia e pazhvilluar me kapacitet të ulët për të krijuar vende të reja pune dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar<sup>126</sup>. Punëdhënësit e anketuar në kuadër të një studimi të financuar nga USAID kanë qenë të njëzëshëm në pohimin e tyre se kurrikulat e arsimit profesional dhe atij të lartë nuk kanë ndonjë relevancë për tregun e punës në Kosovë, dhe se mungojnë sistemet që bëjnë ndërlidhjen në mes të kurrikulave dhe tregut të punës<sup>127</sup>. Në disa fakultete të UP ekzistojnë borde industriale të cilat kanë për qëllim të adresojnë probleme të kësaj natyre nga aspekti përmbajtësor, ndërsa mekanizma konsultative ekzistojnë edhe në disa institucione të tjera të arsimit të lartë.

126 Statman, J., Huibregste, A., Pupovci D., Mullahatihiri V.: Kosovo Workforce Readiness Assessment, USAID, 2015. [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00KH27.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00KH27.pdf)

127 Po aty.

Sidoqoftë, një problem thelbësor i ndërlidhjes së sistemit të arsimit të lartë me tregun e punës, ka të bëjë me shpërputhjen në mes të ofertës dhe kërkesës, respektivisht programeve që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë dhe nevojave të tregut të punës. Tabela 12 jep një pasqyrë të programeve të akredituara sipas fushave të studimit të përcaktuara nga Eurostat<sup>128</sup>. Nga tabela vërehet se rreth 70% të programeve studimore janë nga fusha e edukimit, arteve dhe shkencave humane, shkencave shoqërore dhe shëndetësisë.

**Tabela 12.** Programet e akredituara në vitin akademik 2017/18 sipas fushave të studimit

Fushat e studimit	Sektori publik	Sektori privat	Total
Edukimi	10.45%		6.46%
Shkencat humane dhe artet	14.09%	10.29%	12.64%
Shkencat shoqërore, biznesi dhe drejtësia	31.36%	51.47%	39.04%
Shkencat e natyrës, matematika dhe kompjuterika	9.55%	2.94%	7.02%
Inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi	21.36%	13.24%	18.26%
Bujqësia dhe veterina	5.00%	0.00%	3.09%
Shëndeti dhe Mirëqenia	5.91%	17.65%	10.39%
Shërbimet	2.27%	4.41%	3.09%

Burimi: AKA, <http://akreditimi-ks.org/docs/Reports/AllSP53.pdf>

128 Fields of Training; the Classification - Cedefop - Europa EU, 1999. [www.cedefop.europa.eu/files/5092\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5092_en.pdf)

Një analizë e nevojave të tregut të punës e realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian<sup>129</sup> vë në pah kërkesën për shkathtësi të ndryshme sipas fushave të studimit, duke ju referuar të dhënave të punësimit në periudhën 2002-2013. Rezultatet janë prezantuar në tabelën 13 ku, krahas të dhënave të punësimit janë edhe të dhënat për regjistrimin e studentëve të rinj në institucionet publike të arsimit të lartë, të nxjerra nga konkurset e shpallura për vitin shkollor 2017/18. Këto të dhëna janë prezantuar në mungesë të të dhënave të sistemuara nga SMIAL për regjistrimin e të gjithë studentëve sipas fushave të studimit.

**Tabela 13.** Vendet e punës në periudhën 2002-2013 dhe studentët sipas fushave të studimit

Fushat e studimit	Regjistrimi i studentëve të rinj në sektorin publik 2017/18	Regjistrimi i studentëve të rinj në sektorin publik 2017/18
Edukimi	6.00%	8.37%
Shkencat humane dhe artet	1.00%	5.91%
Shkencat shoqërore, biznesi dhe drejtësia	28.00%	48.19%
Shkencat e natyrës, matematika dhe kompjuterika	1.00%	7.33%
Inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi	28.00%	16.30%
Bujqësia dhe veterina	4.00%	5.08%
Shëndeti dhe Mirëqenia	3.00%	3.47%
Shërbimet	27.00%	5.33%

Burimet: Labour market assessment - Kosovo 2015, ALLED, Konkurset për pranim në studime baçelor në institucionet publike të arsimit të lartë 2017/18

129 Labour market assessment - Kosovo 2015, ALLED. [http://www.alledkosovo.com/publications/Labor\\_Market\\_Needs\\_Assessments.pdf](http://www.alledkosovo.com/publications/Labor_Market_Needs_Assessments.pdf)

Nga krahasimi i të dhënave në tabelë vërehet se ekziston hiperproduksion i kuadrove në disa fusha siç janë shkencat shoqërore, ku kërkesa e tregut të punës është dukshëm më e vogël sesa oferta. Ndërkaq, ka nevojë për më shumë kuadro në fushën e inxhinierisë dhe atë të shërbimeve (shërbimet personale, të transportit, shërbimet e sigurisë, mbrojtja e mjedisit, etj.).

## 5. Përfundimet

Të gjeturat e kësaj analize tregojnë se arsimit i kushtohet kujdes në politikat qeveritare, por ka ngecje në zbatimin e politikave të përcaktuara, përfshirë Planin Strategjik për Arsim në Kosovë 2017-2021. Këto ngecje nuk kanë të bëjnë vetëm me mungesën e buxhetit, por edhe me çështje të natyrës organizative, ku kërkohet një angazhim i veçantë për jetësimin e masave strategjike nga ana e MASHT-it, si dhe një shkallë e lartë koordinimi me institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal. Është shumë ilustrativ fakti se Qeveria e Kosovës ka aprovuar PSAK-un me buxhet prej €176.9 mil. për pesë vjet, duke konstatuar ekzistimin e boshllëkut prej €89.6 mil., por nuk ka pasur veprime konkrete që të sigurohen këto mjete, edhe pse shumica e nevojshme për vitin 2017 ishte vetëm €9 mil. Po ashtu, nuk është ngritur ndonjë mekanizëm koordinues për zbatimin e PSAK.

Pas publikimit të rezultateve të testit PISA në dhjetorin e vitit 2016, problemet në arsim kanë qenë temë debati në shoqëri. Megjithatë, në shumë raste, debati i tillë ka qenë i orientuar kah gjetja e mënyrave për përmirësimin e performancës në testin PISA, duke injoruar faktin se performanca në këtë test është pasqyrë e gjendjes së arsimit në vend dhe se kërkohet intervenim gjithëpërfshirës në të gjitha segmentet e sistemit që kjo gjendje të përmirësohet. Prandaj, tronditja që ka shkaktuar në shoqërinë kosovare rezultati i testit PISA nuk është përkthyer në mobilizim shoqëror për zbatimin e PSAK. Megjithatë, një numër i masave të PSAK janë zbatuar në kuadër të aktiviteteve të rregullta të MASHT, komunave dhe institucioneve të tjera, ndërsa disa tregues të performancës janë arritur ose edhe janë tejkaluar falë zhvillimeve në vitet e fundit. Më poshtë janë dhënë përfundimet kryesore sipas shtatë fushave që mbulon PSAK.

### 1. PJESËMARRJA DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Kosova ka arritur një shkallë të lakmueshme të pjesëmarrjes në arsimin e obligueshëm, si dhe në arsimin e mesëm të lartë, ndërkaq pjesëmarrja në edukimin parashkollor mbetet sfidë për gjithë shoqërinë, kryesisht për shkak të mungesës së institucioneve me kosto të përballueshme. Braktisja e shkollimit është e një shkalle mjaft të vogël, përveç tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ku kërkohet vëmendje e veçantë.

Fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me talente të veçanta mbeten kategoritë më të marginalizuara në arsimin parauniversitar. Përderisa nuk ekziston ndonjë sistem efektiv i mbledhjes së të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta që do të siguronte pjesëmarrjen e tyre në arsim, në rastin e fëmijëve me talente të veçanta mungon veprimi i organizuar, me përjashtim të disa nismave të shoqërisë civile që synojnë t'i avancojnë prirjet e këtyre fëmijëve.

### 2. MENAXHIMI

Nuk ka pasur progres në rregullimin e statusit të personelit drejtues të shkollave, të cilët vazhdojnë të jenë në varësi të drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave. Po ashtu, nuk ka një sistem të punësimit të punonjësve të arsimit që do të garantonte respektim të kriterëve dhe paanësi me rastin e marrjes së vendimeve për punësim.

Ka pasur ngecje në aprovimin e legjisllacionit të nevojshëm për zbatimin e reformës në arsim. Shembuj konkretë janë ligji për inspektoratin e arsimit dhe ligji për arsimin e lartë, të cilët nuk janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, përkundër faktit se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme nga ana e Qeverisë.

Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe parashkollore është realizuar sipas planifikimit, si dhe furnizimi i shkollave me inventar, ndërkaq nuk ka të dhëna të besueshme për renovimin e objekteve shkollore ekzistuese. Përderisa në zonat rurale ka shumë shkolla që kanë mbetur të pashfrytëzuara nga lëvizjet e popullatës, nëpër zonat urbane ka nevojë të jashtëzakonshme për shkolla të reja. MASHT synon të organizojë mësimin tërëditor dhe kjo kërkon që të gjitha shkollat të punojnë vetëm me një ndërrim.

### 3. SIGURIMI I CILËSISË

Janë bërë hapat e parë në ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. Janë emëruar 140 koordinatorë të cilësisë në shkollat fillore dhe të mesme, ndërsa, duke filluar nga janari i vitit 2018, është ndarë buxheti për 560 nga gjithsej 1,100 koordinatorë sa duhet t'i kenë shkollat e Kosovës. Megjithatë, procesi i emërimit të koordinatorëve ka elemente formalizmi, ndërkohë që disa nga koordinatorët e emëruar nuk janë në gjendje ta kryejnë detyrën e tyre për shkak të ngarkesave të tjera.

Janë krijuar parakushtet ligjore për vlerësimin e performancës së shkollës. Po ashtu, është zhvilluar metodologjia për vetëvlerësimin e shkollës, e cila është pilotuar në 63 shkolla, si dhe metodologjia për vlerësimin e jashtëm, për të cilën janë trajnuar 16 inspektorë të arsimit.

Nuk është ndërmarrë asnjë hap drejt themelimit të Agjencisë për Kurrikulum, Vlerësim dhe Standarde, përkundër faktit se themelimi i kësaj agjencie parashihet me ligjin e vitit 2011.

Administrimi i testeve kombëtare mbetet pikë e dobët e zbatimit efektiv të tyre. Edhe këtë vit, MASHT nuk ka ndërmarrë hapa radikalë për përmirësimin e administrimit.

### 4. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Përkundër aprovimit të akteve juridike dhe politikave që rregullojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve, këtij procesi akoma i mungon koordinimi i mirëfilltë dhe mbështetja në analizë të nevojave. Përzgjedhja e trajnimeve, në masë të madhe, varet nga perceptimet e zyrtarëve të MASHT dhe DKA, si dhe nga prioritetet e donatorëve.

Procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve akoma nuk ka filluar. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë plan i qartë veprimi për zhvillimin e këtij procesi në të ardhmen, përkundër faktit se është punuar në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe trajnimin e inspektorëve. Licencimi i mësimdhënësve bëhet vetëm për nivelin e licencës së karrierës, ku nuk kërkohet vlerësimi i performancës. Edhe pse ishte paraparë në planin e veprimit të PSAK 2017 hartimi i UA për harmonizimin e gradave me sistemin e pagave nuk është realizuar, për shkak të mungesës së buxhetit. Rritja e pagave vazhdon të bëhet në mënyrë lineare dhe jo në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

### 5. MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Zbatimi i kurrikulës së re filloi përkundër mungesës së teksteve mësimore dhe mjeteve të konkretizimit që janë në përputhje me kërkesat e kurrikulës së re. Nga shkollat raportohen vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e kurrikulës së re që janë pasojë e përgatitjeve të pamjaftueshme dhe mungesës së mbështetjes së vazhdueshme profesionale. Nuk është përcaktuar procesi i hartimit të teksteve të reja shkollore, nuk është shpallë konkursi për tekste të reja shkollore dhe as nuk janë pranuar dhe shqyrtuar propozimet nga shtëpitë botuese. Për më tepër, vazhdon të ketë dilema nëse tekstet shkollore do të hartohen nga botues vendorë, do të përkthehen nga gjuhë të huaja apo do të merren nga Shqipëria.

### 6. AAP dhe ARr

Rreth 47% të nxënësve të arsimit të mesëm profesional vijnë në mësimet në drejtimit ekonomike-juridike dhe ato shëndetësore, me mundësi dukshëm më të vogla punësimi, ndërkohë që numri i nxënësve në drejtime me perspektivë më të mirë punësimi vazhdon të jetë nën nivelin e dëshiruar. Nuk ka lëvizje të duhura nga MASHT dhe DKA-të për ndryshimin e kësaj gjendjeje.

Materialet mësimore adekuate ekzistojnë për 24 nga 135 profile të arsimit profesional, ndërsa në profilet tjera është i pranishëm një lloj “improvizimi” me shfrytëzimin e materialeve të përgatitura nga mësimdhënësit që nuk kanë kaluar nëpër ndonjë proces verifikimi. Ka ngecje në adresimin e këtij problemi.

Informatat nga terreni flasin për probleme serioze në realizimin e praktikës profesionale dhe për mbështetjen e këtij aspekti të zhvillimit të nxënësve në nisma që burojnë drejtpërdrejtë nga shkolla. Me pak përjashtime, këshillimi dhe orientimi në karrierë vazhdon të mos jetë i pranishëm në shkollat profesionale të Kosovës.

Përkundër progresit në ofrimin e programeve për të rritur, arsimiti i të rriturve mbetet sektori më i pazhvilluar i sistemit të arsimit, pasi ende nuk janë krijuar parakushtet e domosdoshme për menaxhimin e tij.

### 7. ARSIMI I LARTË

Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e lartë është 84.23% që e radhitë Kosovën në vendin e tetë në botë, ndërsa i tejkalon të gjitha vendet evropiane përveç Greqisë, Spanjës, Bjellorusisë dhe Finlandës. Shkalla e diplomimit me kohë për gjeneratën 2013/14 është 43.68% që është akoma larg nga caku i përcaktuar prej 60%.

Numri i stafit akademik të kualifikuar në institucionet e arsimit të lartë është i pamjaftueshëm – derisa përpjesëtimi “mësimdhënës-student” në nivel vendi është 1:41, në sektorin publik mbetet akoma më i pavolitshëm – 1:60. Megjithëse ka përmirësime në zbatimin e kriterëve për zgjedhjen e stafit akademik, nuk ka pasur veprime konkrete për adresimin e shkeljeve flagrante të integritetit akademik nga ana e ndonjë institucioni të arsimit të lartë në Kosovë.

Vazhdon të ketë shpërputhje në mes të ofertës së programeve të arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës, si në aspektin përmbajtësor dhe cilësor, ashtu edhe në aspektin e orientimit të studentëve në ato fusha të studimit ku ka më shumë nevojë për kuadro.

Përkundër disa hapave pozitivë në zbatimin e standardeve të cilësisë, Bordi i AKA është shkarkuar në shtatorin e vitit 2017 pas kërkesës së Kryeministrit të Kosovës, me arsyetim se mban përgjegjësi për gjendjen në arsimin e lartë.

**Nga të gjeturat e analizës mund të nxirren këto rekomandime:**

- 1** MASHT-i duhet të ngritë një mekanizëm për koordinimin e zbatimit të PSAK 2017-2021 të udhëhequr nga Ministri ose zëvendësministri, ku duhet të marrin pjesë zyrtarë të lartë të MASHT, përfaqësues të pushtetit lokal dhe institucioneve të tjera që kanë obligime rreth zbatimit të PSAK-ut, përfaqësues të partnerëve zhvillimorë dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertë të arsimit. Detyrë e këtij mekanizmi do të ishte hartimi i planeve vjetore për zbatimin e PSAK-ut, rishikimi i progresit dhe këshillimi rreth hapave që duhet ndërmarrë për të siguruar zbatimin e plotë të planit strategjik.
- 2** Kujdes i veçantë në fushën e pjesëmarrjes në arsim duhet t'i kushtohet nivelit parashkollor, ku duhet të vazhdohet me investime në infrastrukturë dhe rritjen e përfshirjes në nivelin parafillor. Duhet të mbështeten qendrat mësimore për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, që të mundësohet pjesëmarrja dhe sukcesi i tyre në shkollim, si dhe duhet vazhduar me dhënie e bursave për nxënësit e shkollave të mesme nga këto komunitete.
- 3** MASHT duhet të aprovojë kritere dhe procedura unike dhe të qarta për punësimin e drejtorëve dhe mësimdhënësve në arsimin parau-niversitar, në mënyrë që të minimizohet mundësia e punësimeve jomeritore dhe politike në sistemin e arsimit.
- 4** Kuvendi i Kosovës duhet të aprovojë Ligjin për Inspektoratin e Arsimit që hap rrugën për funksionalizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Po ashtu, duhet të mbështeten shkollat që ta përmbushin funksionin e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- 5** Administrimi i testit të arritshmërisë dhe provimit shtetëror të maturës duhet të bëhet në atë mënyrë që të sigurohet besueshmëria e rezultateve, qoftë edhe duke marrë masa radikale ndaj shkelësve të rregullave të testit, përfshirë edhe administratorët.
- 6** Përkundër rezultatit jo të kënaqshëm të testit PISA, përpjekjet e MASHT dhe të gjithë faktorëve tjerë relevantë duhet të orientohen në përmirësimin thelbësor të gjendjes në sistemin e arsimit, e jo në përmirësimin mekanik të rezultateve të testit. Për më tepër, MASHT duhet të sigurojë një administrim kredibil të testit PISA, në mënyrë që rezultati të reflektojë gjendjen reale në sistemin e arsimit.
- 7** Rritja lineare e pagave të punonjësve të arsimit duhet të ndërpritet sepse nuk ka asnjë efekt të vetëm pozitiv. Për të motivuar mësimdhënësit për punë më të mirë, duhet të funksionalizohet urgjentisht sistemi për licencimin e mësimdhënësve, ndërsa pagat të lidhen me nivelin e licencës.
- 8** MASHT duhet të bëjë aranzhime të veçanta për monitorimin e zbatimit të kurrikulës së re dhe ofrimin e ndihmës shkollave në zbatimin e saj. Po ashtu, duhet të zgjidhet problemi i teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore në mbështetje të zbatimit të kurrikulës. Është i domosdoshëm hartimi i një plani për pajisjen e shkollave me teknologji dhe shfrytëzimin efektiv të saj.
- 9** Në bashkëpunim me DKA-të duhet bërë një rishikim të rrjetit të shkollave të arsimit profesional që të mos krijohet papunësi strukturore me regjistrimin e numrit të madh të nxënësve në drejtime ku mundësia e punësimit është e vogël, ndërkohë që ka mungesë të nxënësve në disa drejtime të tjera që kërkohen nga tregu i punës. Po ashtu, është e nevojshme që të përmirësohet puna praktike dhe këshillimi në karrierë, në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës.
- 10** Për shkak të numrit enorm të studentëve dhe numrit të vogël të personelit akademik të kualifikuar, gjendja në arsimin e lartë nuk është e qëndrueshme. Për këtë arsye, kërkohet që AKA të vendosë kritere të qarta të cilësisë, në aspektin infrastrukturor, të përmbajtjes së programeve mësimore, si dhe në aspektin e numrit dhe cilësisë së stafit akademik, duke insistuar në përmbushjen e tyre nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, pavarësisht nëse janë publike ose private. Për këtë qëllim, AKA duhet të ketë kapacitete për monitorimin e vazhdueshëm të institucioneve të arsimit të lartë, ashtu siç parasheh legjislacioni, si dhe duhet të sigurohet pavarësia e AKA nga ndikimet politike.



